GRAĐANSKA
ALIJANSA
Civic Alliance - Aleanca Qytetare

Gazetaria hulumtuese
nën prizmin e studentëve

GRAĐANSKA ALIJANSA
Civic Alliance - Aleanca Qytetare

Gazetaria hulumtuese nën prizmin e studentëve

Podgoricë, maj, viti 2021

Botues

GRAĐANSKA ALIJANSA
Civic Alliance - Aleanca qytetare

Titulli i publikimit
Gazetaria hulumtuese nën prizmin e studentëve

Për botuesin
Boris Raoniq

Redaktorë
Jelena Ristoviq
Milan Radoviq

Përkthimi
Admir Gjoni

Disenji dhe përkujdesja grafike
APPrint

Shtypur në shtypshkronjën
APPrint

Tirazhi
100

GradjanskaAlijansaCG
@GACrnaGora
gradjanskaalijansa
office@gamn.org
www.gamn.org
Studentska ulica br. 21/a, Lamela 9, st. 5, Podgorica
+382 20 513 687

CIP - Каталогизација у публикацији
Национална библиотека Црне Горе, Цетиње
ISBN 978-9940-741-16-7
COBISS.CG-ID 17622788

Lejohet referimi dhe shfrytëzimi i informatave nga ky publikim me citimin e obligуar të burimit dhe të pronarit të të drejtave autoriale.
Nuk lejohet shfrytëzimi i materialit për çfarëdo qëllimi pa miratimin paraprak të Aleancës Qytetare (AQ).
Shprehjet të cilat në këtë publikim përdoren për personat fizik të gjinisë mashkullore nënkuptojnë shprehjet në gjininë femërore.
Për pjesët e publikimit të marra nga burimet e jashtme, AQ s'mban përgjegjësi.

Ky projekt pjesërisht është financuar nga Ambasada e SHBA-së në Podgoricë. Mendimet, gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet të paraqitura këtu janë qëndrim i autorit dhe jo domosdoshmërish pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit / Qeverisë së SHBA-së.

Përmbajtja:

Hyrje 7

Angjella STESHEVIQ dhe Violeta Hajrizaj
Çështja e vaksinimit dhe e mosvaksinimit të fëmijëve 9

Danica Bogdanoviq dhe Svetllana Erakoviq
Shkelën Kushtetutën gjatë krizës së koronës 17

Ivana Terziq dhe Lidija Roganoviq
Inicimi i prodhimtarisë në Kriporen e Ulqinit nuk është i mundshëm këtë vit 25

Ivana Terziq
Klinikat private raportojnë shtetin nëpërmes ndërhyrësit 39

Jelena Vukashinoviq dhe Vuk Vujisiq
Bukovica – krimi pa drejtësi 49

Jelena Vukashinoviq
Rrëqebulli ballkanik: Macja së cilës ne ia premë rrugën 55

Milica Lipovac dhe Violeta Hajrizaj
Përparimi në sundimin e ligjit është jetik 65

Nikola Savelliq
Drejtësia në pritje 75

Sandra Miliqeviq dhe Lidija Roganoviq
Institucionet e transferojnë përgjegjësinë kur kërkohen shifrat 81

Vuk Vujisiq
Tubat janë rritur, llojet e mbrojtura të harruara 87

HYRJE

Të nderuar lexues,

Para jush është publikimi "Gazetaria hulumtuese nën prizmin e studentëve", të cilin e përgatiti Aleanca Qytetare në kuadër të projektit "Gazetaria etike dhe profesionale për studentët". Projektin e realizuam në bashkëpunim me Ambasadën e SHBA-së në Podgoricë.

Publikimi përmban dhjetë shkrime hulumtuese të përgatitura nga 11 gazetarë dhe studentë të rinj malazez, pasi ndoqën programin e menduar me kujdes të trajnimeve me gazetarët e njohur vendas, gjatë të cilit iu përçuan eksperiencat dhe dijen e vet, duke i udhëzuar gjatë tërë procesit, nga identifikimi i idesë deri tek teksti përfundimtar.

Shkrimet hulumtuese mbulojnë disa nga temat më të rëndësishme reformuese me të cilat ballafaqohet shoqëria malazeze në rrugën e integrimit në Bashkimin Evropian dhe adoptimit të Sistemit kompleks të standardeve – nga mbrojtja e të drejtave të njeriut, krimet e luftës, mbrojtja e mjedisit jetësor, deri tek sundimi i ligjit, si korniza më e gjerë e mundshme brenda së cilës vështrohet sistemi publik dhe aftësia e tij për t'u përgjigjur nevojave të qytetarëve.

Temat janë tejet të rëndësishme për tërë shoqërinë dhe gazetarët tonë të rinj ia dolën me sukses që me shkrimet e veta hulumtuese në mënyrë të thjeshtë dhe ilustruese të shpjegojnë se si këto tema, standardet në këto lëmi dhe reformat vijuese ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve. Me këto shkrime dëshiruam të tregojmë për rëndësinë e raportimit etik dhe profesional në ambientin ku ndjehet rritja e informatave të rrejshme, të cilat duhet t'i kundërshtojmë në planin më të gjerë shoqëror, duke e promovuar alfabetizmin mediatik dhe gazetarinë cilësore.

Shkrimet e përmendura tashmë janë botuar në faqen e internetit të Aleancës Qytetare dhe janë promovuar përmes rrjeteve tona sociale, e po ashtu u transmetuan edhe nga shumë media malazeze, duke filluar nga MINA, agjencia informative, deri tek gazeta ditore DAN dhe portali Vijesti. Reagimet e opinionit dhe të komunitetit në internet ishin më shumë se pozitive, prandaj edhe në periudhën e ardhshme do ta vazhdojmë bashkëpunimin me gazetarët e rinj me qëllim të angazhimit më aktiv të tyre në përpunimin e temave me të cilat organizata jonë merret tradicionalisht.

DETYRIM APO ZGJEDHJE

Çështja e vaksinimit dhe e mosvaksinimit të fëmijëve

Tek një numër i prindërve shfaqet dyshimi lidhur me nevojën e dhënies së dozave të përsëritura të vaksinave. Pediatrët dhe imunologët, megjithatë, shprehen se përgjigjja e matshme e antitrupave nuk zhvillohet te të gjithë fëmijët pas një doze, kështu që doza e përsëritur ose e ashtuquajtura buster doza do të provokojë një përgjigje të tillë tek 100 për qind e fëmijëve. Këtu qëndron shkaku se përse vaksinimi bëhet disa herë, me përjashtim të vaksinës BSG, e cila ka funksionin e parandalimit të formave të rënda të tuberkulozit pas lindjes.

Autorët:

Angjella Steshevіq

Violeta Hajrizaj

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) vlerëson se imunizimi shpëton për çdo vit rreth dy apo tre milionë jetë në botë, kurse parandalimi i sëmundjes nëpërmjet vaksinimit paraqet intervenimin më ekonomik të mundshëm në shëndetësi. Sëmundjet e rëndomta të fëmijëve të gjeneratave të mëhershme janë bërë gjithnjë e më të rralla duke iu falënderuar vaksinës, kurse programet e imunizimit masiv janë treguar të suksesshme në kontrollin apo zhdukjen e disa sëmundjeve.

Momentalisht ekzistojnë vaksinat për parandalimin e më tepër se 20 sëmundjeve vdekjeprurëse. Para se fushata masive e vaksinimit ka eliminuar të gjitha shfaqjet natyrore të variolës në vitin 1980, sëmundja ka rrezikuar 60 për qind të popullsisë botërore dhe ka shkaktuar vdekje te një në katër pacientë. Duke iu falënderuar vaksinës, njerëzimi e ka çrrënjosur këtë sëmundje.

Pasi që OBSH nisi Iniciativën Globale për zhdukjen e poliomelitit në vitin 1998, rastet e raportuara të kësaj sëmundjeje u reduktuan për 99 për qind. Vlerësohet se paraliza është parandaluar te 10 milionë njerëz. Mes viteve 2000 dhe 2014, numri i të vdekurve nga morbili (fruthi) ka rënë për 79 për qind në tërë botën. Fatkeqësisht, zhdukja e kësaj sëmundjeje varet ende nga informimi i njerëzve.

Përvojat e prindërve

Kur bëhet fjalë për fëmijët e lindur para kohe, imunizimi i rregullt i tyre shpesh shtyhet, sepse shumë pediatër mendojnë se sistemi imunitar i dobësuar i foshnjave mund të shtyjë ndjeshëm reagimet ndaj vaksinave antigjene dhe zvogëlojë efektet mbrojtëse të vaksinimit.

Për shkak të epidemisë së koronavirusit, sistemi i vaksinimit po e humb ngadalë rregullsinë e vet. Fokusi aktual i personelit mjekësor është pandemia, megjithëse edhe nevojat tjera mjekësore duhet edhe më tej të përmbushen në vazhdimësi.

Nevenka Kapiçiq, nënë e dy fëmijve, apelon tek prindërit që rregullisht t'i vaksinojnë fëmijët e tyre dhe në këtë mënyrë të krijojnë parakushte për të ardhme të shëndoshë dhe të lumtur.

- Bota po na tregon pa mëdyshje se si duket ajo pa vaksina. Do të ishte marrëzi të kthehemi në periudhën e disa sëmundjeve që vaksinat i kanë çrrënjosur, mos t'i shfrytëzojmë përparësitë e zhvillimit të civilizimit dhe benefitet e qarta të mjekësisë. Po ashtu, nuk ia vlen të debatosh me rrymat kundër vaksinimit dhe të biesh nën ndikimin e tyre, duke vendosur të mos vaksiononi fëmijën tuaj – ka thënë Nevenka.

Prema njenom mišljenu, trend vakcinacije opada na svjetskom nivou, a to prati i Balkan. Uprkos tome, redovnost vakcinacije kod nas još uvijek ima stabilan kontinuitet, koji se mora održavati.

Sipas mendimit të saj, trendi i vaksinimit është në rënie në nivel botëror, kurse kjo po e ndjekë edhe Ballkanin. Përkundrejt kësaj, vaksinimi i rregullt tek ne ka ende vazhdimësi stabile që duhet mirëmbajtur.

Nevenka thotë se është e domosdoshme të dëgjohet udhëzimi i pediatrit lidhur me vaksinimin e fëmijëve.

"Çështja e vaksinimit të fëmijës nuk është çështje personale, por ka të bëjë me komunitetin e gjerë. Nëse trendi i mosvaksinimit rritet në mënyrë të shpejtë, do të reflektohet tek të gjithë. Në të njëjtën kohë nuk duhen prindërit të marrin një vendim të tillë në emër të fëmijës, i cili më vonë mund të përjetojë në lëkurën e vet sëmundjet e rënda vetëm sepse nuk e kanë mbrojtur prindërit përmes imunizimit, megjithëse kanë pasur mundësi ta bëjnë këtë shumë thjeshtë", ka theksuar ajo.

Kapiçiq shton se shteti ka rol kyç në këtë aspekt nëse fëmijët vaksinohen dhe nëse ekziston ndonjë mekanizëm që mund t'i orientojë për t'u vaksinuar.

"Shteti është ai që kornizat e veta ligjore duhet t'i orientojë drejt respektimit të sistemit të vaksinimit për mirëqenien e fëmijëve dhe shoqërisë, si dhe të ndërtojë sistem efikas të dënimit në rast të mosvaksinimit. Mentaliteti ynë nuk reagon ndaj sugjerimeve dhe këshillave, por ndaj gjobës me të holla, kështu që këtë duhet shfrytëzuar sistematikisht për qëllime korrektuese", mendon Kapiçiq.

Ajo thotë se një përqindje e vogël e prindërve është në dilemë kur duhet të vaksinojë fëmijën e vet dhe se tek ata ndikim më të fuqishëm ushtrojnë rrymat e caktuara në rrjetet sociale dhe propagandat kundër vaksinës. Tek ata duhet të veprojë sistemi shëndetësor përmes edukimit dhe masave të tjera, në mënyrë që të eliminojë hapësirën për dilemë.

Ngjashëm mendon edhe bashkëbiseduesi Enis Eminoviq, babai i vajzës të cikën "e ruan si gllënkën e ujit në pëllëmbën e dorës". Ai i këshillon prindërit e vetëdijshëm që në mënyrë të rregullt t'i vaksinojnë fëmijët e vet, në të kundërtën prindërit duhet të sanksionohen.

"Prindërit duhet të kenë pasqyrë të qartë para syve të tyre se nuk ekzistojnë fakte shkencore të qarta se ekziston çfarëdo lidhjeje ndërmjet vaksinimit dhe disa gjendjeve të rënda të cilat lidhen me to, por po ashtu nuk ka dëshmi që vaksina është plotësisht e sigurt. Në çdo rast, nuk ka arsye për frikë, sepse efektet anësore serioze shfaqen më rrallë sesa komplikimet e sëmundjes në rast të mosvaksionimit", thotë Enis Eminoviq.

Ana tjetër e medaljes

Një nënë 39-vjeçare, e cila ka dashur të mbetet anonime, na ka rrëfyer se e ka vaksinuar rregullisht fëmijën e parë derisa i ka mbushur 12 muaj, kurse tjetrin fare. Deri në mars të vitit 2012 ajo ka konsideruar se vaksina është e rëndësishme, me ç'gjë nuk e ka kontestuar efikasitetin e saj, Përmbajtja, prodhuesin.

"Përse në një fëmijë të lindur shëndosh të injektojnë çfarëdo substancash kimike, për të cilat nuk e dimë se si do të reagojnë, nëse ekziston ndonjë faktor gjenetik i cili me vaksinën mund të shkaktojë kushedi çfarë pasojash në zhvillimin e mëtejshëm. Të mos flas sidomos për fëmijët të cilët që në fëmijëri kanë ndërlikime dhe t'u jepet diçka për ç'gjë nuk e dimë nëse i dëmton apo jo. Shanset janë më të mëdha që të shfaqet ndërlikimi nga vaksina sesa që fëmija të fitojë TBC-në ose hepatitin B. Jemi në shekullin 21 dhe kushtet e jetesës janë përmirësuar goxha", thotë ajo.

Përvojat personale të kësaj nëne e cila është vaksinuar në vitet e nëntëdhjeta nuk janë më të mirat. Ishte luftë dhe në atë kohë askush nuk merrej me vaksina. Kujton se të gjithë, pasi që e kishin marrë vaksinën, në klasën IV ose V kishin varrë në vendin ku e kishin marrë atë vaksinë, e cila me muaj krijonte qelb dhe të gjithë kishin fituar temperaturë. Në fillim të janarit të vitit 2013, një muaj e gjysmë pas vaksinimit MMR, ka vërejtur te fëmija ënjtje të lehtë në gjurin e djathtë, kyçin e këmbës së majtë dhe gishtat e dorës së djathtë. Fëmija ishte i vogël, akoma pa i mbushur dy vjeç, askush nuk mund të përcaktonte diagnozën, kurse rezultatet e analizave ishin të rregullta.

"Kemi kaluar nëpër agoni derisa nuk takuam doktoreshën nga Instituti për Reumatologji nga Beogradi, e cila ka përcaktuar diagnozën si artrit i fëmijëve (diagnoza JIA) që bën pjesë në sëmundjet autoimune. Mjekësia zyrtarisht nuk ka ilaç, vetëm mund të ruhet në gjendje remisioni. Sëmundja ka karakter reumatik dhe të sëmurët me këtë diagnozë jo rrallëherë, gjatë dhjetë viteve bëhen invalidë në masë të madhe ose të vogël", thotë kjo nënë.

Ajo tregon se shtatzënia ishte e rregullut si edhe vetë lindja. Ka lindur në prag të moshës tridhjetëvjeçare. Me bashkëshortin janë moshatarë, të dy janë shëndoshë dhe pa sëmundje të rënda. Faktori gjenetik është përjashtuar, askush nuk ka pasur reumatizëm apo artrit në familje në të kaluarën e afërt.

Si prind ka filluar të hulumtojë për vaksinimin dhe ky është shkaku përse nuk e ka vaksinuar foshnjën e saj të dytë. Nëse lind fëmijën e tretë thotë se nuk do vaksinojë as atë.

"Pas diagnostifikimit kam filluar si prind të hulumtoj se për çfarë bëhet fjalë dhe se si fëmija pa i mbushur dy vjeç mund të fitojë reumatizëm të pashërueshëm?! Nuk e dija as që ekziston një gjë e tillë derisa nuk u futëm në qarkun e nemur të spitaleve, rrëfimeve të frikshme të prindërve, diagnozave, fëmijëve aq të sëmurë saqë kurrë nuk do të mund të funksionojnë normalisht. Ishte e çuditshme për mua se të gjithë ata fëmijë ishin vaksinuar dhe se në shumicën e rasteve problemi ishte shfaqur menjëherë pas marrjes së vaksinës", ka theksuar ajo.

I ka pyetur mjekët dhe pediatrët, si dhe të gjithë profesionistët se nëse MMR ia ka "ngjitur" fëmijës së saj senilitetin deri në fund të jetës. Askush nuk ka thënë jo, gjë që asaj i duket e çuditshme. Përgjigjet ishin diplomatike, se vaksinimi ka shumë mundësi të ishte shkas.

"Çfarë do të thotë kjo?! Nëse ju gjuaj, mbase mund të mbijetoni, mbase jo. Shpjegim i çuditshëm, por i vetmi që mund të ma ofronin si profesion", flet e dëshpëruar nëna.

Në atë kohë kishin filluar zërat, mjaft të ndrojtur, për pasojat e vaksinave dhe lidhjen e tyre me autizmin. Kjo kishte nxitur akoma më shumë dyshimin e saj për të lexuar më shumë se për çfarë bëhet fjalë. Është përpjekur të gjejë tekste serioze mbi përbërjen e vaksinave dhe efektet anësore, në mënyrë që të marrë vendimin më të mirë për fëmijën që ka dhe atë që do të vijë në jetë.

Ajo mendon se njerëzit duhen të informohen, të lexojnë, të vështrojnë fëmijën e vet sa më shumë dhe atëherë të marrin vendime.

"Unë këtë s'e kam bërë me fëmijën e parë, por kam vepruar ashtu siç thonin të tjerët dhe sepse ashtu duhej. Tani, mjekësia zyrtare i çon duart nga ne, kurse fëmija im nëntëvjeçar së bashku me ne lufton me sëmundjen", flet me hidhërim bashkëbiseduesja jonë.

Edhe bashkëbiseduesja jonë e dytë anonime po ashtu ka vendosur për mosvaksinim në një moment, pavarësisht se nuk ka pasur përvojë negative me vaksinat.

"Kemi ndaluar marrjen e vaksinave, sepse fëmijët në fqinjësi kanë pasur pasoja që me siguri mund t'u atribuohen vaksinave – artriti juvenil pas MMR-së, paraliza e përkohshme

(dymujore) pas vaksinës OPV dhe diabeti pas vaksinës Hib. Kemi hasur në mjekë dhe personel mjekësor të cilët janë munduar të na nxisin për t'i vaksinuar fëmijët dhe të njohur të cilët, të paprovokuar nga asgjë, janë munduar të na imponojnë mendimin e tyre mbi vaksinat. Por kemi qëndruar të vendosur në vendimin tone", thekson kjo nënë.

Opinioni i profesionit

"Edhe sot, vaksinimi konsiderohet jo vetëm një nga arritjet më të mëdha mjekësore, por edhe një nga zbulimet më të rëndësishme të civilizimit tonë. Nga origjina pothuajse empirike e vaksinologjisë deri te vaksinomia e sotme, njohuritë tona kanë evoluar ndjeshëm dhe ne kemi mësuar leksione të rëndësishme. Edhe pse qëllimi kryesor i vaksinës është mbrojtja e drejtpërdrejtë ndaj një mikroorganizmi të caktuar, gjegjësisht sëmundjes që ai shkakton, fusha e vaksinimit është zgjeruar me zbulimin se vaksinat mund t'i mbrojnë po ashtu njerëzit e pavaksinuar duke arritur imunitetin kolektiv, përmes të ashtuquajturit efekt mbrojtës i tufës apo edhe që vaksina të caktuara mund të mbrojnë edhe kundër sëmundjeve të tjera nga ato për të cilat janë krijuar para së gjithash, falë të ashtuquajturave efekte heterologe", tha D. S., pediatër dhe specialist i imunologjisë. Ai thekson se njëra nga vaksinat më efektive në vazhdimësi është ajo kundër tërbimit, sepse nëse pacienti nuk merr mbrojtje adekuate, shkalla e vdekshmërisë është njëqind për qind.

Ekspertët pohojnë se për shkak të pamundësisë së sistemit imunitar të të porsalindurit për ta luftuar vetë infeksionin, vaksinimi është thelbësor. Vaksinimi i hershëm po shfaqet gjithnjë e më shumë si një përparësi globale e shëndetësisë. Tek foshnjat është bërë rutinë përdorimi i vaksinës BCG, si dhe vaksinat kundër hepatitit B. Punonjësit mjekësorë theksojnë se BCG është një nga vaksinat më të përdorura në botë, me mbi tri miliardë njerëz të vaksinuar dhe është dëshmuar me efikasitet të lartë dhe të shkëlqyeshëm. Përjashtim bëjnë foshnjat e lindura para kohe, sepse në mesin e imunologëve ekziston një konsensus që sistemi imunitar i pazhvilluar i këtyre fëmijëve do t'i shtypte antigjenet e vaksinës dhe kështu do të zvogëlonte efektin e saj mbrojtës.

Bashkëbiseduesi ynë thekson me vendosmëri se fëmijët nuk marrin shumë vaksina njëkohësisht, para së gjithash pasi që fëmija është i rrethuar nga një mjedis steril para lindjes, ndërsa qysh gjatë lindjes është i ekspozuar ndaj mikrobeve që zakonisht gjenden në trupin e njeriut. Sidoqoftë, kontakti me mikrobe patogjene të veçanta para se të

mbushë një vit çon në pasoja të rënda dhe një shkallë të lartë të vdekshmërisë, karakteristikë kjo e periudhave historike para zbulimit të vaksinave. Kalendari i vaksinimit përpilohet duke pasur parasysh ndërtimin imunologjik karakteristik për një moshe të caktuar, ose bazuar në shkallën e rrezikut nga infeksioni.

Një numër i prindërve ka dyshime lidhur me nevojën e dhënies së dozave të përsëritura të vaksinave. Pediatrit dhe imunologët, megjithatë, theksojnë se përgjigjja e matshme e antitrupave nuk zhvillohet te të gjithë fëmijët pas një doze të vetme, kështu që doza e përsëritur ose e ashtuquajtura dozë përforcuese, nxit përgjigje të tillë te madje 100 për qind e fëmijëve. Kjo është arsyeja që vaksinat jepen disa herë, me përjashtim të asaj BSG të lartpërmendur, e cila ka funksionin të parandalojë zhvillimin e formave të rënda të tuberkulozit pas lindjes.

Është e rëndësishme të theksohet se niveli i antitrupave në organizmin e njeriut zvogëlohet me kalimin e kohës, prandaj është e domosdoshme të merren përsëri disa lloje të vaksinave. Kështu, mbrojtja kundër tetanosit e marrë në moshën tetëmbëdhjetë vjeç mbron dhjetë vitet e ardhshme nga kjo sëmundje e rëndë.

Ithtarët e vaksinimit shpesh me gjysmë shaka theksojnë se të gjithë kundërshtarët e vaksinimit masiv edhe vetë janë vaksinuar. Vaksinat po ashtu kanë përparuar me kalimin e kohës. Ta zëmë, për shembull, dikur është përdorur vaksina kundër kollës së madhe, e cila shpesh shkaktonte temperaturë të lartë, bile edhe efekte anësore më serioze, ndërsa sot përmban një toksinë të dobësuar të bakteries që e shkakton këtë sëmundje, e cila nuk shkakton pothuajse asnjë efekt anësor.

Shkencëtarët e mjekësisë tregojnë se vetë fakti që me dakada nuk ka pasur raste të të sëmurëve prej rubeolës, difterisë, fruthit ose kollës së madhe, në atë masë saqë një pjesë e kosiderueshme e punonjësve shëndetësorë, veçanërisht në vendet mesatarisht të zhvilluara dhe të zhvilluara, nuk kanë hasur kurrë pacientë me këto sëmundje, nuk do të thotë që patogjeni sëmundje-shkaktues nuk është i pranishëm në mjedis apo në popullatë. Imuniteti i shkaktuar nga vaksinimi është pikërisht ai që arrin të eliminojë shkaktarin para se të shkaktojë sëmundjen. Gjithashtu, nuk duhet përjashtuar asnjëherë mundësinë që disa sëmundje infektive do të „importohen“ nga vendet tjera, edhepse nuk është më e pranishme në vendin tonë, kështu që kontrollet aktive kryhen gjithmonë, si p.sh. për virusin e poliomelitit. Do të dukej e papërgjegjshme të mendohet se shkaktari

i sëmundjes është zhdukur nëse vetë sëmundja nuk regjistrohet më: përkundrazi, ajo është e pranishme, por është vaksinimi i rregullt që e mban atë nën kontroll.

Midis sigurisë personale dhe kolektive

Duket se ka më tepër arsye për vazhdimësinë e praktikës së vaksinimit masiv, sepse rreziku i shfaqjes së epidemive të pakontrolluara dhe i përhapjes së sëmundjeve infektive, si dhe i rritjes së morbiditetit te popullata më e brishtë, është shumë më i madh sesa efekti i pavërtetuar që vaksinimi mund të ketë te përqindja e ulët e popullatës, tek e cila shfaqen rrallë efektet e padëshiruara. Po ashtu, sa më tepër pjesëtarë të popullatës njerëzore të imunizohen, qoftë edhe përmes rrugës artificiale, d.m.th. nëpërmjet vaksinimit masiv, në këtë mënyrë edhe e gjithë popullata është më mirë e mbrojtur nga infektimi. Sepse, sa më infektiv (virulent) të jetë një bacil, aq më e madhe do të jetë përqindja e popullatës që duhet mbuluar me programet e vaksinimit dhe imunizimit.

Pa dyshim, ekzistojnë persona tek të cilët vaksina mund të shkaktojë kundërindikacione, siç është rasti me çdo lloj ilaçi. Por, duket e vështirë të pranohet qëndrimi se për shkak të këtyre rasteve të izoluara dhe, deri tani të pakonfirmuara shkencërisht, duhet të rrezikojmë shëndetin dhe jetën, si të fëmijës së vet ashtu edhe të tjerëve, të cilët me siguri do të ishin të rrezikuar në rast se lejohet të jenë të ekspozuar ndaj patogjenëve pa kurrfarë mbrojtjeje. Mirëpo, solidariteti dhe empatia ndaj viktimave eventuale të reagimeve kundërindikacion ndaj vaksinimit na bën jo që të shmangim vaksinimin, por që si shoqëri, media, por edhe organizata si OBSH, duhet të ushtrojnë presion ndaj industrisë farmaceutike që në mënyrë transparente të hulumtojë rastet e tilla dhe të bëjë çmos që vaksinat e reja të jenë më të avancuara në aspektin teknologjik dhe të sigurta për të gjithë.

EPIDEMIA E KORONAVIRUSIT SOLLI SHKELJE TË SHUMTA TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Shkelën Kushtetutën gjatë krizës së koronës

Autorët:

Danica Bogdanoviq

Svetllana Erakoviq

Epidemia e koronavirusit solli shkelje të shumta të të drejtave të njeriut. Që nga 16 marsi, kur u raportua rasti i parë i infeksionit në Malin e Zi, Drejtoria e Policisë ka ngritur 2,211 kallëzime penale kundër 3,378 personave për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale të mosrespektimit të rregullave shëndetësore për luftimin e sëmundjes infektive të rrezikshme.

Nga Institucioni i Mbrojtësit të të Drejtave dhe Lirive të Njeriut shpjeguan se të drejtat e njeriut janë shkelur për disa arsye. Që nga shpallja e pandemisë së sëmundjes infektive të koronavirusit deri më 15 dhjetor, ky institucion ka pranuar 771 ankesa*.

“Unë konstatoj se periudha e pandemisë ka shkaktuar cenime të pjesshme të të drejtave të njeriut në sferën ekonomike dhe shoqërore, kurse koha që kaloi ka hapur dilema të shumta në lidhje me dimensionet e tjera të të drejtave të njeriut, veçanërisht kur bëhet fjalë për të drejtat civile. Megjithëse, nuk mund të flasim për shkelje masive dhe sistematike të të drejtave të njeriut, ka pasur shkelje të dukshme në fushën e kufizimeve të të drejtave dhe lirive, veçanërisht nëse marrim parasysh standardet ndërkombëtare dhe mënyrën e zbatimit të tyre në legjislacionin vendas, gjegjësisht, mënyrën në të cilën organet shtetërore i zbatojnë këto standarde në një rast ose raste konkrete“, na tha Avokati i Popullit Sinisha Bjekoviq.

Pasojat e pandemisë tregojnë tashmë ekspozimin ndaj rrezikut shtesë të disa kategorive shoqërore (të papunët, njerëzit me të ardhura të ulëta, familjet e moshuara, personat me aftësi të kufizuara, gratë dhe fëmijët, viktimat e dhunës në familje, popullata LGBTIQ).

"Nga praktika jonë, është më se e sigurt se duhet pasur kujdes që të mos tejkalohet pragu i vendosur nga standardet ndërkombëtare gjatë zbatimit të kufizimeve, nëse nuk është i përcaktuar në mënyrë të qartë dhe preciz nga ligjet e brendshme. Po ashtu, pavarësisht nga fakti që kemi një qëllim legjitim si motiv për vendosjen e kufizimit, ai nuk mund të aplikohet pa bazë të qartë në ligj. Përndryshe, të drejtat e njeriut do të jenë gjithmonë në rrezik të ndërhyrjes arbitrare nga shteti në sferën e mbrojtur të individit, që nuk mund të justifikohet si qëllim, as që mjeti për të arritur atë qëllim nuk mund të konsiderohet i nevojshmëm ose proporcional në drejtim të realizimit të interesit publik që përpiqet të mbrohet", deklaron Bjekoviq.

Njëra prej të drejtave të njeriut që u sulmua e para pas shpalljes së epidemisë në Mal të Zi ishte kufizimi i lirisë së lëvizjes. Liria e lëvizjes është e drejtë e njeriut në fushën e të drejtave dhe lirive personale, e cila garantohet me Kushtetutë. Kjo liri mund të kufizohet në raste të justifikuara dhe një nga kufizimet është nevoja për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve infektive. E lidhur ngushtësisht me të është e drejta për të lëshuar vendin, e cila mund të kufizohet për të njëjtën arsye.

Të turpëruar publikisht për shkak të shëndetit

Publikimi i listës së personave në vetizolim në faqen zyrtare të Qeverisë së Malit të Zi, me pëlqimin paraprak të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, rrezikoi të drejtat e njeriut në mënyrë të padiskutueshme. Lista përmbante emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit.

Për këtë vendim të Trupit (Komisionit) Kombëtar të Koordinimit, Qeveria njoftoi se „e kishte miratuar pasi ishte vërejtur se persona të caktuar po shkelnin masat, duke e ekspozuar të gjithë Malin e Zi ndaj një rreziku të lartë". Pas publikimit të listës që stigmatizoi drejtpërdrejt një numër të caktuar qytetarësh, OJQ-të e shumta për të drejtat e njeriut kritikuan këtë procedurë (veprim). Më 23 mars, OJQ Aleanca Qytetare paraqiti para Gjykatës Kushtetuese iniciativën për të vlerësuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e Vendimit të Komisionit Kombëtar të Koordinimit për të publikuar emrat e personave të cilëve u janë lëshuar vendime për vetizolim të detyrueshëm.

Gjykata Kushtetuese nuk reagoi në kohë, por disa muaj më vonë e shfuqizoi vendimin për publikimin e listave të personave në vetizolim. Gjykata Kushtetuese filloi procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit të KKK-së, me iniciativën e Organizatës Joqeveritare Aleanca Qytetare, në seancën e mbajtur më 29 maj.

„Lidhur me lëndën U-II, nr. 22/20, Gjykata Kushtetuese nxori Vendimin që shfuqizon Vendimin e KKK-së për publikimin e emrave të personave në vetizolim, nr. 8-501 / 20-129, me datë 21 mars 2020 dhe pushon së qeni i vlefshëm ditën e publikimit të këtij Vendimi“, është publikuar në faqen e *internetit të Gjykatës*.

- *u predmetu **U-II broj 22/20,** donio Odluku o **ukidanju** Odluke Nacionalnog koordinacionog tijela za zarazne bolesti o objavljivanju imena lica u samoizolaciji, broj 8-501/20-129., od 21. marta 2020. godine i prestaje da važi danom objavljivanja ove Odluke.*

Shkelja serioze e të drejtave të njeriut ndodhi kur lista e të infektuarve me virusin korona „rrodhi“ në publik, sepse nxjerrja e informacionit në lidhje me statusin shëndetësor të pacientëve paraqet shkelje të rëndë të së drejtës së privacisë. Pas kësaj ngjarjeje, Qeveria e Malit të Zi lëshoi deklaratë zyrtare, në të cilën ata u bënë thirrje institucioneve kompetente shtetërore që të hetojnë urgjentisht burimin e kësaj liste dhe të identifikojnë ata që shpërndajnë informacionin. I dyshuari më pas edhe u arrestua.

Njëra prej atyre që i janë shkelur të drejtat e njeriut gjatë epidemisë është ZH.M, identiteti i së cilës është i njohur për studentet që punuan në këtë tekst. Për shkak të problemeve shëndetësore, ajo qëndroi në Beograd, nga ku u kthye në momentin kur u shpall epidemia në Malin e Zi.

„Kah mesi i marsit, emri im u shfaq në listën famëkeqe, të botuar në faqen e internetit të Qeverisë, në të cilën unë u etiketova si një person që potencialisht ka virus dhe mund ta transmetojë atë tek të tjerët. Kështu, unë isha e ekspozuar drejtpërdrejt ndaj stigmatizimit, shikimeve dënuese të fqinjëve të mi kur dola në ballkonin e banesës ku jetoj, prandaj më vonë vendosa të padis shtetin“, tregon ZH. M.

Kjo situatë, thotë ajo, nuk është e vetmja që ka cenuar të drejtat e saj themelore të njeriut.

„Fillimisht m’u caktua izolimi për 14 ditë, kurse pas skadimit të kohës së caktuar më njoftuan se izolimi më shtyhet edhe për 14 ditë, megjithëse nuk kisha asnjë simptomë, për ç’gjë e informoja çdo ditë Institutin për Shëndetin Publik. Për shkak të problemit tim shëndetësor

me këmbën time, izolimi më ra edhe më rëndë, sepse në një apartament të vogël ishte e vështirë për mua të lëvizja. Gjithashtu, duke marrë parasysh që nuk jam nga Podgorica dhe se nuk kam asnjë të afërm këtu, duke mos qenë në gjendje të dilja për gati një muaj, ishte edhe më e vështirë për mua, sepse unë duhej t'u kërkoja njerëzve të tjerë shërbime në mënyrë që të ushqehesha", thotë ZH. M.

Ajo nuk është e vetmja. Edhe nikshiqanët V. C. dhe A. E. konsiderojnë se nuk i gëzuan të gjitha të drejtat e njeriut gjatë epidemisë së koronavirusit.

„Më gjobitën në fund të prillit ose në fillim të majit, sepse u ula në një stol në park me një shok - për shkak të qëndrimit në vend publik dhe shkeljes së distancës të caktuar. Për këtë arsye na gjobitën - në vlerë prej 400 eurosh. Mendoj se kanë vepruar padrejtësisht, sepse parku ishte plot dhe vetëm ne dy u arrestuam dhe u dënuam", tha V. C.

„Mendoj se ishte fillimi i majit kur u ndëshkova për mosrespektimin e orarit të kufizimit të lëvizjes. Ata më gjetën pas orës 19 dhe më dënuan me dy vjet burg me kusht, që mendoj se është shumë", thotë A. E.

Në anën tjetër, ekspertët sigurojnë se gjatë periudhës së koronavirusit të drejtat e njeriut janë shkelur nga shumë aspekte.

Liria e lëvizjes, e drejta e praktikimit të besimit, e drejta për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Janë kufizuar ose rrezikuar edhe të drejtat si: e drejta për liri, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, liria e besimit, liria e mbledhjes dhe e asociimit, e drejta për gëzimin e papenguar të pronës, e drejta për arsimim (këto të drejta dhe liri burojnë nga Konventa Evropiane dhe protokollet e saj). Nga Kushtetuta e Malit të Zi: e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik, e drejta për lirinë e lëvizjes, e drejta për privatësi, mbrojtja e të dhënave personale, e drejta për lirinë e besimit, liria e tubimit.

„Burgu" në burg

Gëzimi i të drejtave të caktuara të njeriut u është mohuar gjithashtu personave të privuar nga liria, të cilët ndodhen në reparte të posaçme të Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Domethënë, ata i kishin absolutisht të ndaluara vizitat gjatë epidemisë. Gjithashtu, në kushtet e epidemisë së sëmundjes infektive është regjistruar edhe problemi i mbipopullimit në qendrat e paraburgimit të policisë.

Foto: Arkive privatë, Danica Bogdanoviq

E ndaluar apo jo?

Një nga masat e Trupit (Komisionit) Koordinues Kombëtar, që ka cenuar një nga të drejtat e njeriut, sigurisht ishte tubimi në mjedisin publik.

Masat që ndalonin tubimet publike parandaluan mbajtjen e ceremonive fetare në prani të besimtarëve.

Duke iu referuar publikimit „Testimi i shoqërisë ndaj Covid 19“ të OJQ „Aleanca Qytetare“, masat parandaluese janë zbatuar në mënyrë selektive, kështu që për shkeljen e masës mbi lëvizjen ndërmjet qyteteve prifti i Mitropolisë Malazeze-Bregdetare është gjobitur me 4,500 euro, ndërsa për të njëjtat vepra, personat publikë janë gjobitur me 500 euro ose më pak.

Edhe pse tubimet publike ishin të ndaluara, konform masave parandaluese epidemiologjike të Komisionit Kombëtar të Koordinimit, çdo ditë kishte raste të shkeljeve të masave.

Lititë, gjegjësisht shëtitjet me lutje, të karakterizuara edhe si protestë kundër Ligjit për

Lirinë e Besimit, i cili u miratua në fund të vitit 2019 dhe të organizuara nga Mitropolia Malazeze-Bregdetare, nuk u organizuan gjatë epidemisë.

Sidoqoftë, më 12 maj, në Nikshiq, ndodhi tubimi masiv në ditën e Shën Vasilit të Ostrogut. Njerëzit e tubuar dolën në shëtitje, prandaj u arrestua peshkopi i Budimles dhe Nikshiqit, Joanikije, së bashku me tetë priftërinj të tjerë të Kishës Ortodokse Serbe. Pas litisë, peshkopi dhe priftërinjtë u mbajtën për 72 orë në ndërtesën e Qendrës së Sigurisë në Nikshiq.

Masatë i kanë sjellë, masat i kanë shkelur

Pas kësaj, filloi fushata parazgjedhore për zgjedhjet parlamentare, që ishte një terren i përshtatshëm për shkeljen e masave. Megjithatë, shkeljet më serioze të masave epidemiologjike ndodhën pas zgjedhjeve.

Kështu, natën e zgjedhjeve, festimi i rezultatit të zgjedhjeve u organizua në të gjithë Malin e Zi. „Maskat“ dhe „distanca“, mund të thuhet, se ishin harruar. Mosrespektimi i masave mund të vërehej edhe tek ata që i fituan zgjedhjet. Me përjashtim të natës së zgjedhjeve, më 30 gusht, edhe të nesërmen u organizuan kremtime në disa qytete.

Foto: Arkive privatë, Danica Bogdanoviq

Vetëm disa ditë më vonë, u organizuan edhe të ashtuquajturat „tubime patriotike“. Së pari në Cetinë e pastaj në Podgoricë, ku u regjistruan disa raste të shkeljes së masave epidemiologjike nga ata që, në një mënyrë të caktuar, edhe i sollën ato.

Foto: Arkive privatë, Danica Bogdanoviq

Kështu, në tubimin në Cetinë u filmua anëtari i Komisionit Koordinues Kombëtar të atëhershëm dhe kryetari i Komunës së Podgoricës, Ivan Vukoviq. Ai nuk mbante maskë, as distancë, por i shkelte masat edhe me vetë praninë e tij në tubim, pasi tubimet ishin të ndaluara. Prokuroria, megjithatë, vlerësoi se në këtë rast nuk kishte asnjë vepër penale.

Foto: Rrjete sociale

Një numër i madh i tubimeve u zhvilluan pa reagimin adekuat nga institucionet kompetente. Varrimi i Mitropolitit Malazeze-Bregdetar, Amfillohije, u përshkua nga shkelja e masave. Përveç numrit të madh të qytetarëve që morën pjesë në varrim, një numër i konsiderueshëm zyrtarësh ishin në Kishën e Ringjalljes së Krishtit atë ditë, kurse më së shumti u kritikua Zdravko Krivokapiqi, në atë kohë mandator për formimin e qeverisë, i cili nuk mbante maskë.

Foto: Arkive privatë, Danica Bogdanoviq

Përderisa masat u bënë të pakuptimta nga ata që duhet të jepnin shembull se si respektohen vendimet e autoriteteve kompetente, numri i të infektuarve me koronavirus erdhi duke u rritur nga dita në ditë.

Duket sikur nuk ka më rëndësi se a është papërgjegjësi e individit, institucionit apo shoqërisë në tërësi. Kriza e koronës, për fat të keq, konfirmoi „thënien e vjetër popullore“ - rregullat ekzistojnë për t'u thyer (shkelur)!

*** Në këtë statistikë janë numëruar ankesat mbi të gjitha bazat.**

INICIMI I PRODHIMTARISË NË KRIPOREN E ULQINIT NUK ËSHTË I MUNDSHËM KËTË VIT

Inicimi i prodhimtarisë në Kriporen e Ulqinit nuk është i mundshëm

Importi mesatar vjetor i kripës që nga viti 2013 vlen mbi një milion euro. Importet rekord u regjistruan në vitin 2019, kur u importua kripë me vlerë 1,311,581 euro.

Autorët:

Ivana Terziq

Lidija Roganoviq

Kriporja „Bajo Sekuliq“ në Ulqin është e sigurt se nuk do të prodhojë kripë as këtë vit, që do të thotë se do të importojë kripë me vlerë më shumë se një milion euro në tregun malazez, gjë që ndodhi në pesë vitet e mëparshme. Rifillimi i prodhimit do të kishte rëndësi të shumëfishtë. Me këtë do të ruhej ekosistemi që po prishet me shkatërrimin e fabrikës dhe infrastrukturës së saj, gjë që ndikon drejtpërdrejt në uljen e numrit të zogjve që vizitojnë vendin. Qeveria lokale do të përfitonte gjithashtu nga rifillimi i prodhimit të kripës, sepse do të krijonte vende të reja të punës dhe do të zvogëlonte importin e kripës. Krahas kapaciteteve prodhuese që ka Kriporja, në planin afatgjatë, skenari më ambicioz do të përfshinte edhe eksportin në formën e produkteve të reja të tilla, si p.sh. „lulja e kripës“.

Foto: Peđa Perović

Sipas të dhënave të Monstatit, Mali i Zi në vitin 2013 deri në vitin (grumbullimi i fundit i kripës) deri në vitin 2019 ka importuar mesatarisht në vit kripë në shumën 1,084,011 euro. Kjo është dukshëm më shumë sesa mesatarja e regjistruar nga viti 2005 deri më 2013, kur ishte 640,000 euro.

Përfaqësuesit e qeverisë së re malazeze vizituan zonën e Kripores që në muajin e parë të mandatit të tyre, duke dashur të tregojnë se sa e rëndësishme është ajo zonë për pushtetin ekzekutiv.

Megjithatë, ata mendojnë se nuk ka kohë të mjaftueshme që prodhimi i kripës të fillojë deri këtë verë. Ky vlerësim konfirmohet edhe nga ekspertët vendas, të cilët thonë se për të filluar prodhimin është e domosdoshme përgatitja e terrenit, që do zgjaste më shumë se nëntë muaj.

Studimet e deritanishme kanë treguar se vlera ekonomike në nivel vjetor e Kripores është mbi pesë milionë euro.

Kriporja e Ulqinit „Bajo Sekuliq“ është një nga ndërmarrjen më të vjetra në Mal të Zi, e cila shtrihet në një sipërfaqe prej 14.5 kilometra katrorë. Për sa i përket sipërfaqes, bën pjesë ndër dhjetë më të mëdhatë në Mesdhe. Basenet më të vjetra të kripës u ndërtuan

nga viti 1926 deri më 1934, ndërsa Kriporja u projektua për të prodhuar 30 mijë tonë kripë. Në atë zonë janë regjistruar rreth 250 specie zogjsh, që është më shumë se gjysma e specieve që vizitojnë rregullisht vendet e Bashkimit Evropian, ndërsa 70 për qind të regjistruara në territorin e Malit të Zi. Nga të gjitha këto specie, 60 janë vizitorë të shpeshtë, 69 të rrallë, kurse 46 vizitorë të përkohshëm të Kripores së Ulqinit. Me vlerë të veçantë janë speciet kryesore - flamingo, por edhe pelikani kaçurrel.

Foto: Peđa Perović

Studimet tregojnë se për shkak të menaxhimit joadekuat të regjimit të ujit, biodiversiteti është përkeqësuar. Studimi i kryer për nevojat e Qendrës për Mbrojtjen dhe Studimin e Zogjve tregon se ndërsa më herët ishin regjistruar 55 fole, gjatë vitit 2017 ishin regjistruar 55 fole. Është më se e qartë se ka zvogëlim të zogjve individualë që e shfrytëzojnë këtë zonë për ushqim dhe pushim gjatë pranverës, vjeshtës, dimrit dhe migrimeve.

Në të njëjtin studim "Analiza e sfidave ligjore dhe institucionale në procesin e integrimit në BE dhe mbyllja e kapitullit 27" theksohet rënia e frekuentimit të flamingove viteve të fundit.

Sipas studimit të rastit, të kryer nga MANS-i, mbyllja e fabrikës dhe mos mirëmbajtja e infrastrukturës që po shkatërrohet, rezultuan në pamundësinë e menaxhimit adekuat të

ujërave, gjë që ka për pasojë ndikimin negativ në ekosistem, i cili, ndër të tjera, rezulton me mungesë të ushqimit për shpezë.

Në Ministrinë e Ekologjisë së Qeverisë së Malit të Zi besojnë se rifillimi i punës së Kripores dhe valorizimi i saj i qëndrueshëm do të sillnin përfitime për Malin e Zi, posaçërisht Komunës së Ulqinit dhe qytetarëve të saj.

Por pushteti lokal në Ulqin, referuar përgjigjeve të Ministrisë së Ekologjisë, tashmë i ka humbur afatet për të krijuar një ndërmarrje që do të menaxhojë Kriporen, në bazë të vendimit për shpalljen e Kripores të mirë natyrore.

Kriporja është shpallur zonë e mbrojtur në nivelin kombëtar në qershor 2019 dhe sipas Ministrisë, komuna e Ulqinit është dashur që deri më 1 korrik 2020 të themelonte ndërmarrjen për menaxhimin e saj, gjë që nuk e ka bërë.

Sipas vlerësimeve të tyre, fillimin e prodhimit të kripës për momentin e pengojnë sidomos marrëdhëniet e pazgjidhura pronësore-juridike në zonën e Kripores, prandaj konsiderojnë se është e domosdoshme që të zgjidhet sa më parë ky problem.

- Për fat të keq, nuk besojmë se është e mundur t'i përgatisim të gjitha aktivitetet e domosdoshme dhe të përfundojmë procesin deri në fillim të sezonit të verës – theksohet në përgjigjet që kemi marrë nga Qeveria e Malit të Zi, e cila premton se do ta shikojë me përparësi zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore në Kripore.

Kriporja "Bajo Sekuliq" u privatizua në vitin 2003, në vitin 2005 në këtë kompani u shpall falimentimi, kurse prodhimi i kripës është ndaluar në vitin 2013.

Plani i pronarëve të rinj për të ndërtuar kompleks turistik në zonën e Kripores u ndalua nga aktivistët e OJQ-ve, të mbështetur nga ambasadorja e atëhershme e Republikës së Gjermanisë, Gudrun Steinacker, e cila arriti ta vendosë çështjen e Kripores në mesin e çështjeve prioritare në bisedimet për anëtarësimin e Malit të Zi në BE.

Pasi u shpall zonë e mbrojtur, Kriporja u përfshi në listën Ramsar të njëjtin vit.

Tre modele të zhvillimit të kripores

Në rrugën e rinisjes së prodhimtarisë në Kripore, është e domosdoshme të ndërmerren edhe disa hapa, ka treguar ky hulumtim.

Në pritje të shpalljes të Kripores së Ulqinit si e mirë natyrore e mbrojtur, nga ekspertët evropianë është kryer "Studimi i mbrojtjes së Kripores së Ulqinit", në të cilin janë adresuar të gjitha çështjet me rëndësi për këtë lokalitet.

Në Studim është përgatitur analiza fillestare e investimeve të nevojshme dhe shpenzimeve rrjedhëse të mirëmbajtjes së zonës për dy mundësitë (opsionet), njëra prej të cilave ka tre skenarë që përfshijnë edhe mundësinë që Kriporja të funksionojë edhe si zonë e mbrojtur.

Opsioni 1: Revitalizimi i prodhimit të kripës me 3 nën-skenarë të përpunuar:

Skenari 1.1: Produkti bazë është **kripa për rrugët** në vëllimin e prodhimit siç ka qenë deri në vitin 2013 (17,000 tonë). Investimi fillestar vlerësohet në shtatë milionë euro, me koston vjetore të menaxhimit 1.15 milion euro. Numri i nevojshëm i të punësuarve për prodhimin e kripës është 46, numri i të punësuarve për menaxhimin e zonës së mbrojtur është nëntë, ndërsa është parashikuar që është e nevojshme të punësohen 168 punëtorë sezonalë. Kjo domethënë se gjithsej 223 persona do të angazhoheshin në rast të zgjedhjes së këtij opsioni.

Studimi ka vlerësuar se ky opsion nuk është fitimprurës, sepse çmimi i këtij lloji të kripës është jashtëzakonisht i ulët në treg, kërkesa për produktin është e ndryshueshme, mundësinë e distribuimit në treg duhet të shikohet, ndërsa nevojitet të prodhohen dhe shiten sasi të mëdha të kripës. Shpenzimet e investimit fillestar janë shumë të larta.

Skenari 1.2: Avancimi në prodhimin e **kripës për ushqim** me një rafineri kripe, për prodhimin vjetor prej 25,000 tonelata kripë ushqimore, e cila e tejkalon kapacitetin e Kripores në 10 vitet e fundit të funksionimit. Investimi fillestar vlerësohet në 10.5 milionë euro, me koston vjetore të menaxhimit prej 1.35 milion. Numri i nevojshëm i të punësuarve për prodhimin e kripës është 61, numri i të punësuarve për menaxhimin e zonës së mbrojtur është nëntë, ndërsa parashikohet që nevojiten të punësohen 168 punëtorë sezonalë. Kjo do të thotë se

gjithsej 238 persona do të angazhoheshin në rast të zgjedhjes së këtij opsioni.

Studimi ka vlerësuar fitimin deri në 150,000 euro, si dhe që në një të ardhme të afërt, fitimi nga vizitat mund të arrinin prej 175,000 deri në 350,000 euro në vit. Te ky opsion theksohet veçanërisht çështja e mundësisë së shitjes së një sasie të madhe të kripës ushqimore në një treg të ngopur.

Skenari 1.3: Prodhimi i sasive të vogla të kripës në një zonë të kufizuar, me një fokus në një **produkt të ri kripe, të ashtuquajturin "Lulja e kripës"** (megjithëse edhe pjesa e mbetur e zonës do të duhej të restaurohet në mënyrë që të përmbushë kërkesat e ruajtjes së biodiversitetit përmes rregullimit të regjimit të ujit). Investimi fillestar vlerësohet në katër milionë euro, me një kosto vjetore menaxhimi prej 500,000 euro. Numri i punonjësve të kërkuar është 21, ndërsa numri i punonjësve për menaxhimin e zonës së mbrojtur është nëntë dhe është planifikuar që të angazhohen 30 punëtorë sezonalë. Kjo bën që të angazhohen gjithsej 60 persona në rast të zgjedhjes së këtij opsioni.

Studimi ka vlerësuar fitimin deri në 70,000 euro, si dhe që në të ardhmen e afërt, fitimi nga vizitat mund të arrijë prej 175,000 deri në 350,000 euro në vit. Sistemi për vizitorët mund të përfshijë suvenire të veçanta dhe produkte të fabrikës së kripës, me një ofertë të veçantë të "lules së kripës", e cila mund të shitet në tregun evropian, ndërsa numri i vizitorëve në zonë do të rritej gradualisht.

Opsioni 2: Menaxhimi i zonës si e mbrojtur me prodhimin e kripës në një zonë rreptësisht të kufizuar, vetëm për qëllime promovuese dhe arsimore.

Investimi fillestar vlerësohet në tre milionë euro, me një kosto vjetore menaxhimi prej 600,000 euro. Numri i të punësuarve për prodhimin e kripës është 16, numri i të punësuarve për menaxhimin e zonës së mbrojtur është 11, ndërsa parashikohet që është e nevojshme të angazhohen 20 punëtorë sezonalë. Kjo bën që gjithsej të angazhohen 47 persona në rast të zgjedhjes së këtij opsioni.

Studimi ka vlerësuar një fitim deri në 70,000 euro, si dhe që në të ardhmen e afërt, fitimi nga vizitat mund të arrijë prej 175,000 deri 350,000 euro në vit.

Importi

Sipas të dhënave të Monstatit, nga viti 2005 deri në vitin 2019 është importuar kripë me një vlerë prej 12,707,106 euro. Kjo do të thotë se mesatarja vjetore e importit të kripës është 847,140 euro. Të dhënat tregojnë se importi i kripës po rritet nga viti në vit. Më i ulët ishte në vitin 2005 - në vlerën 364,436 euro dhe më i lartë në vitin 2019 - 1,311,581 euro.

Nga grumbullimi i fundit i kripës në vitin 2013, deri në vitin 2019, është importuar kripë në vlerën 7,588,082 euro, ose mesatarisht 1,084,011 euro në vit.

Nga viti 2015 deri në 2019, vlera e importit vjetor të kripës e tejkalon një milion euro.

Nga këndvështrimi i punëtorëve

Sipas ish-shefit të sektorit të përgjithshëm, financiar dhe tregtar në Kriporen e Ulqinit ”Bajo Sekuliq”, Sasha Mitroviq, në vitin e parë, do të duheshin më shumë se 1.5 milion euro për t’i kthyer terrenet e Kripores në gjendjen para vitit 2013 dhe të mundësojmë prodhimin.

Foto: Peđa Perović

Shpenzimet fillestare, sipas tij, përfshijnë blerjen e disa makinerive (ekskavatorë) që janë të domosdoshëm për punën në terren dhe për kostot e mëvonshme për të mbuluar punën dhe materialin (dërrasat).

- Në bazë të një studimi të bërë nga ne ish-punonjësit e Kripores tre vjet më parë, në atë kohë nevojiteshin rreth 1.3 milion euro dhe një periudhë kohore prej gjashtë deri në nëntë muaj. Sot duhen të së paku 30 për qind më shumë para dhe disa muaj më shumë, sepse terrent janë shkatërruar edhe më shumë – vlerëson Mitroviq.

Ai beson se aktiviteti kryesor në vitin e para apo dy vitet e para do të ishte vetëm aftësimi i terrenit, sepse, siç shpjegon ai, nga disa liqene në të cilët qarkullonte uji i detit, për shkak të mospunës është krijuar një liqen etj.

"Sipas studimit tonë, do të ishte e nevojshme që gjashtë deri në nëntë muajt e ardhshëm të punësojmë tetë pompistë dhe pesë persona që kujdesen për ujin, tre deri në katër brigadierë si punëtorë të përhershëm. Vlerësimi im është se nevojitet të angazhohen edhe rreth 30 punëtorë fizikë (sezonalë), të cilët do të punonin në terren nën praninë e përhershme të një ose më shumë teknologëve tanë me përvojë dhe disa brigadierëve", shpjegon Mitroviq.

Me një staf të tillë, ai beson se puna mund të organizohet në dy turne kur lejojnë kushtet atmosferike.

Duke folur për rëndësinë e Kripores për Ulqinin, ai thekson se në të kaluarën ishte krenari jo vetëm e atij qyteti por e tërë Malit të Zi.

"Solana ishte brend i këtij qyteti, në hyrje të Ulqinit qëndronte për një kohë të gjatë tabela me tekstin MIRË SE VINI NË QYTETIN E KRIPES. Brezat e bashkëqytetarëve tanë u arsimuan me ndihmën e Kripores", kujton Mitroviq.

Sipas tij, në fillim të viteve '90 ishin të punësuar 450 njerëz, që do të thotë se Kriporja ushqente po aq familje. Ai gjithashtu thekson rëndësinë e Kripores si një habitat i madh për zogjtë dhe vlerëson se ky lloj turizmi po zhvillohet me të madhe në botë.

"Gjithashtu, balta mjekësore nga Kriporja mund të shfrytëzohet për qëllime mjekësore", shton Mitroviq.

Janjusheviq: E paguajmë shtrenjtë kripën e Himalajeve, ndërsa kriporja jonë po shkatërrohet

Drejtoresha ekzekutive e Qendrës për Mbrojtjen dhe Studimin e Zogjve, Jovana Janjusheviq, thekson se kthimi i prodhimit të kripës jo vetëm që do t'u ndihmonte zogjve, por edhe punëtorëve të keqtrajtuar, ekonomisë lokale dhe krenarisë kombëtare.

"Është ironike që sot e paguajmë shtrenjtë kripën e Himalajeve ose çdo lloj tjetër kripe në treg, ndërsa kriporja jonë praktikisht po shkatërrohet, ndërsa ja kohës së fundit edhe po shpuplohet deri në vidën e fundit, e zhveshur dhe e përçudnuar si në luftë", theksoi ajo.

Foto: Peđa Perović

Ajo konsideron se duhet të merret si model habitati i ngjashëm me Kriporen e Ulqinit në rajon. Shembull i mirë, siç vlerëson, është Kriporja Nin në Kroaci, kurse posaçërisht nënvizon Kriporen Shkocijanski zatok në Sllloveni, e cila nuk ka prodhim, por, siç thekson ajo, është e qëndrueshme falë ndihmës së projekteve të BE-së dhe një ekipi cilësor të njerëzve.

Pavarësisht nga situata aktuale, e cila nuk lë shteg për shumë optimizëm, ajo shpreson që stafi profesional për menaxhimin e Kripores do të sigurohet.

„Ne presim që menaxheri i ardhshëm të angazhohet së shpejti nga Ambasada e Gjermanisë, e cila ofroi ndihmë në gjetjen e stafit cilësor për këtë pozitë, sepse Kriporja aktualisht është në një gjendje të tillë që nuk duhet të eksperimentojmë me stafin politik, i cili mbase mund të ketë vullnet por jo njohuritë dhe përvojën e nevojshme“, ka vënë në dukje Janjusheviq.

Pronësia

Sipas studimit “Kriporja e Ulqinit - Analiza e sfidave ligjore dhe institucionale në procesin e integrimit në BE dhe mbylljen e Kapitullit 27”, përgjigjja në pyetjen e pronësisë së çdo pasurie të paluajtshme merret me një shikim të thjeshtë në kadastrën e pasurive të paluajtshme 25.

„Kështu që vijmë deri te të dhënat që patundshmëritë të cilat përfshihen në kufijtë e Parkut të Natyrës „Kriporja Ulqinit”, parcela kadastrale (PK) 30/3 e regjistruar në Fletën Poseduese (FP) numër 3, Zona Kadastrale (ZK) Fusha e Ulqinit gjendet në pronësi të shtetit të Malit të Zi, ndërsa të drejtën e disponimit e ka Komuna e Ulqinit, PK 364, 376, 377 dhe 404/2 në të njëjtën ZK, të regjistruara në FP 271, gjenden në pronësi të Malit të Zi, ashtu që në ZK 363 dhe 404/2 të drejtën e shfrytëzimit e kanë Të Mirat Detare, kurse për ZK 376 dhe 377 ekziston shënimi i të drejtës zyrtare të CEDIS-it (Sistemi Malazez i Elektroshpërndarjes)“, theksohet në studim.

Në anën tjetër, për PK numër 30/2, 358, 359, 360, 362, 363/1, 363/2, 395, 396, 397, 398, 399, 400, 401, 402, 403, 404/1, 405, 406, 407 dhe 410, të regjistruara në FP 182, ZK Fusha e Ulqinit dhe PK numër 1242/2 dhe 1270, të regjistruara në FP numër 98, ZK Zogaj, nuk ka të dhëna mbi pronarin, ndërsa si shfrytëzues në masën 1/1 është e regjistruar OP Kriporja „Bajo Sekuliq”, dhe i regjistruar shënimi i procedurës së falimentimit 26.

Fabrika e kripës dhe falimentimi

Vlera e Kripores së Ulqinit në vitin 2000 është vlerësuar në 110.3 milionë marka gjermane në atë kohë, e cila korrespondon me vlerën rreth 55 milionë euro, tregon studimi i rastit që është kryer nga MANS-i.

Plani i privatizimit të Kripores për vitin 2000 dhe 2001 parashikohej të bëhej përmes dy metodave: privatizimit masiv me vauçerë dhe shitjes së aksioneve në treg, e ashtuquajtura "batch sale".

Gjithsej 59.28 për qind e kapitalit ishte përcaktuar për privatizimin masiv me vauçerë, 10.43 për qind e aksioneve u takoi punëtorëve, kurse 35.83 për qind e kapitalit ishte planifikuar për shitje përmes metodës "batch sale".

Deri në vitin 2003 u shitën 59.37 për qind e kapitalit të Kripores së Ulqinit. Në vitet 2003 dhe 2004 ishte planifikuar të privatizohet pjesa e mbetur prej 40.63 për qind e kapitalit të Kripores përmes kërkimit të një partneri strategjik.

Atë vit kishte interesim nga një partner i huaj për privatizimin e Kripores, por organet e menaxhimit nuk e kryen rritjen e kapitalit fillestar, sepse fondet investuese të privatizimit ishin kundër kësaj.

Në Kriporen "Bajo Sekuliq" SHA u shpall falimentimi në vitin 2005, kur Fondi i Privatizimit "Eurofond" zotëronte 33.87 për qind të kapitalit të përgjithshëm në Kripore, kurse Fondi i Privatizimit "Moneta" 34.67 për qind të kapitalit.

Atë vit, kapitali i ndërmarrjes u zvogëlua për 22.6 milionë për shkak të harmonizimit të regjistrit kontabël dhe vlerës faktike të kapitalit, kështu që ai u përcaktua në rreth 31.2 milionë euro.

Gjendja financiare e ndërmarrjes është përkeqësuar ndjeshëm që nga viti 2005. Kompania, e cila deri në momentin e futjes së falimentimit punonte pothuajse pa humbje, u gremis në humbje të pambuluara në vlerë 7.9 milionë euro në fund të vitit 2013, konkudohet në studimin e rastit të kryer nga MANS-i.

Foto: Pegja Peroviq

Shpenzimi vjetor i kripës për ushqim

Sipas studimit të kryer nga Millosh Vukoviq për nevojat e Qendrës për Studimin dhe Vëzhgimin e Zogjve, thuhet se këtë vit konsumi i banorëve të Malit të Zi është i papërfillshëm në krahasim me kapacitetin prodhues të Kripores së Ulqinit, i cili vlerësohet në 25,000 tonelata, si dhe që potenciali më i madh i konsumit vjen nga turistët.

Për analizë janë shfrytëzuar të dhënat e MONSTAT-it mbi numrin e banorëve në Mal të Zi në vitin 2019, vlerësimet për konsumin janë bërë në bazë të rekomandimeve të OBSH-së së vitit 2013, të cilat përcaktojnë kufirin e sipërm të konsumit ditor të kripës në ushqimin e të rriturve prej 5g në ditë dhe për fëmijët nën 2g/në ditë, si dhe çmimin e një kilogrami të kripës në shitjen me pakicë.

Popullsia e Malit të Zi konsumon 1,013 ton kripë në vit, e cila kap vlerën 405,245 euro.

“Konsumi tjetër i kripës lidhet me kripën për rrugë, sasia e së cilës nuk mund të llogaritet”, theksohet në studim.

Për qëllimet e vlerësimit të nevojave vjetore të kripës për turistët që kalojnë natën në Malin e Zi janë shfrytëzuar të dhënat e MONSTAT-it mbi numrin e fjetjeve të turistëve, supozimi se të gjithë konsumojnë 5 gramë kripë në ditë, si dhe çmimi i një kilogrami kripë në shitjen me pakicë.

Sipas analizës së këtyre të dhënave, rezultati tregon se për nevojat e turistëve janë shpenzuar 23,598 tonë kripë me vlerë 9,439,144 euro.

Konflikti i qetë në mes të administratës së falimentimit dhe punëtorëve

Ish-udhëheqësi i Kripores, Sasha Mitroviq, pohon se pengesa më e madhe për fillimin e prodhimit në atë kompani është administrata e falimentimit, duke e akuzuar atë për mbrojtjen e interesave të pronarit shumicë - Eurofondit.

- Në dy vitet e fundit, pronari shumicë në koordinim me administratën e falimentimit, u prezantua si pronar edhe i pronës dhe aktualisht po zhvillohet një betejë para Këshillit të Privatizimit lidhur me pyetjen se nëse pronari shumicë (FIM Eurofond) ka paguar kompensim të drejtë për tokën e Kripores. Kjo është edhe arsyeja pse administrata e falimentimit ndaloi shitjen e Kripores, e cila sipas ligjit duhej të zbatohej dhe t'u paguajë borxhin kreditorëve (punëtorëve, furnitorëve dhe shtetit) – thekson Mitroviq, duke kujtuar se plani i pronarit shumicë është ndërtimi i një kompleksi turistik me një vend (port) ankorim për 54 lidhje në vendin ku graviton Kriporja drejt Port Milenës, kurse në prapavijë të saj të ndërtojë disa hotele të tipit kondo.

Në anën tjetër, administratori i falimentimit të Kripores "Bajo Sekuliq", Zharko Ostojiq, pretendon se nuk ka interes për të vazhduar prodhimin e kripës. Ai përkujton se në procedurën e falimentimit deri tani janë bërë 15 thirrje publike për shitjen e pronës së Kripores, të cilat kanë përfunduar pa sukses, me përjashtim të një pjese të pajisjeve, lëndëve të para të riciklueshme dhe parkut të automjeteve.

"Vetë fakti që nuk ka kërkesë për blerjen e pronës së Kripores imponon përfundimin se nuk ekziston as interesim për prodhimin e kripës, si një produkt plasmani i të cilit do të mundësonte që firma të punojë me përfitim" thotë Ostojiq.

Sipas tij, gjatë procedurës së falimentimit, me bashkëpunimin e Administratës së Falimentimit, Parqeve Kombëtare të Malit të Zi dhe Qeverisë, është bërë e mundur të ruhet biodiversiteti në zonën e Kripores dhe të zvogëlohen ndjeshëm shpenzimet e procedurës.

"Parqet kombëtare mbulojnë shpenzimet e sigurimit, energjisë elektrike dhe mirëmbajtjes së impianteve të pompimit, të cilat mundësojnë qarkullimin e ujit të detit në zonën e Kripores", deklaron Ostojiq.

Burimet:

1. MANS – Studimi i rastit: Shkatërrimi i Kripores "Bajo Sekuliq" për shkak të interesave të tajkunëve vendorë.

2. QMSZ (CZIP) – Studimi "Me shijen e detit, me shijen e kripës", 2020.

3. Studimi: Kriporja e Ulqinit - Analiza e sfidave juridike dhe institucionale në procesin e integrimeve në BE dhe mbylljes së Kapitullit 27.

4. Studimi i mbrojtjes për zonën e Kripores së Ulqinit, 2017.

METODOLOGJIA E DEPOZITIMIT TË MBETJEVE MJEKËSORE NË MAL TË ZI

Klinikat private raportojnë shtetin nëpërmes ndërhyrësit

Në çfarë mase institucionet private shëndetësore respektojnë dispozitat, nëse kemi parasysh që inspektori për ekologji gjygjeve përkatëse u ka dorëzuar shtatë kërkesa për nisjen e procedures kundërvajtëse kundër institucioneve shëndetësore për shkak të përzierjes së mbetjeve mjekësore me ato komunale, nga viti 2016 deri me sot ?

Autorët:

Ivana Terziq

Jeni në situatë kur nuk dini çfarë të bëni me ilaçe të cilave u ka kaluar afati. Ose keni një person shumë të sëmuarë dhe duhet të eliminoni shishet, gjilpërat…Mbetjet? Tualeti? Deponia?

Pyetja – ku të depozitohen mbetjet mjekësore në kohën e pandemisë së korona virusit bëhet aktuale sepse në të gjitha nivelet është rritur prodhimi i mbetjeve infektuese, i cili nëse nuk trajtohet në mënyrë të duhur, sipas rekomandimeve, mund të shkaktojë hapjen e infektimit. Trajtimi i duhur i mbetjeve mjekësore ka peshë të madhe në ruajtjen e shëndetit publik. Për këtë arsye, Instituti i Shëndetit Publik i Malit të Zi ka paraqitur në sajtin e tij rekomandimet e qarta për depozitimin e duhur të mbetjeve mjekësore qoftë në institucionet shëndetësore sikur edhe në shtëpitë ku qëndrojnë raste të dyshuara apo të konfirmuara të korona virusit.

mzdravlja.gov.me

Mbeturinat personale si dhe tërë mbeturinat të përdoruna nga personi i infektuar (pajisja personale mbrojtëse është përdorë, pecetat e përdorura dhe mbeturinat e tjera të formuara gjatë pastrimit dhe mbeturinat personale të sëmurit) depozitohet në qese plastike për mbeturina me trakën për mbyllje. Qesja plastike pastaj futet në kesë tjetër të mbeturinave dhe lidhet. Qesja me mbeturina duhet të futet në koshin e mbeturinave komunale pas depozitimit më së pakti 72 orë - thuhet në rekomandime.

KONTROLLI I RREPTË

Personi që grumbullon mbeturinat ka për detyrë të përdorë dorëzat njëpërdorimshe, duke mos prekur fytyrën me doreza se mund të jenë të prekura gjatë menaxhimit të mbeturinave. Sipërfaqa e jashtme e dorezave konsiderohet e prekur. Pas heqjes së dorezave, rekomandohet larja e duarve.

Stafi mjekësorë i shërbimeve patronazhe është në obligim që gjatë vizitave në terren dhe të sëmurëve në shtëpia, mbeturinat medicinale të vizitës së mëparshme t'i marrë dhe ti depozitojë në Shtëpinë e Shëndetit në zonën që i përket të sëmurit. Kështu shprehet Ministria e Shëndetit.

Mirëpo, përvoja e qytetarëve tregon të kundërtën. Madje, të gjithë që kemi kontaktuar, shishet dhe gjilpërat e përdoruna i kanë depozituar në mbeturina para se vjen patronazhi. E njëjta vlen për ilaçet që ju ka skaduar afati. Kanë përfunduar në shportat e mbeturinave të të sëmuarit apo në tualete.

Ministria e Shëndetit tregon se për depozitimin e ilaçeve ekzistojnë vende reciklimi apo pjesë të koshave për këto lloje të mbeturinave, duke mos përcaktuar për cilat vende apo koshe bëhet fjalë, apo për numër dhe lokacione.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetit, në institucionet shëndetësore gjatë pesë muajve të para të këtij viti janë prodhuar 146.044 kilogram të mbetjeve mjekësore. Nga ky resorë qeveritarë shprehen se prodhimtaria nuk është rritur për shkak të shtyerjes së ndërhyrjeve kirurgjike dhe të tjera gjatë periudhës së epidemisë së koronavirusit.

Në Mal të Zi, marrjen, grumbullimin dhe menaxhimin e mbetjeve mjekësore e bën konzorciumi i firmës së Podgoricës dhe Italiane „Ekomedika" dhe „OMPeco" që ka filluar me punë në vitin 2013. në bazë të lejes të lëshuar nga Agjencia për Mbrojtjen e mjedisit.

Dy qendra për përpunimin e mbeturinave janë formuar në nivel të shtetit, një në Berane në gjirin e spitalit të përgjithshëm, i dyti në afërsi të Qendrës Spitalore të Malit të Zi.

Sasitë

Vitin e kaluar 32 institucione publike të shëndetit kanë prodhuar 396.748 kilogram të mbetjeve mjekësore, përpunimi i të cilave ka kushtuar 888.120 eura.

Në vitin 2018 janë prodhuar 373.391 kilogram të mbetjeve mjekësore, përpunimi i cilave ka kushtuar 835.836 eura. Në 2017 janë prodhuar 397.732 kilogram, për përpunim janë shpenzuar 875.607 eura. Në vitin 2016 janë prodhuar më së tepërti mbeturina krahas viteve të kaluara – 1,420.601 për çfarë janë shpenzuar 925.955 eura.

NAZIV ZDRAVSTVENE USTANOVE	2016		2017		2018		2019	
	Količina (kg)	Iznos (€)	Količina (kg)	Iznos (€)	Količina (kg)	Iznos (€)	Količina (kg)	Iznos (€)
Dom zdravlja Andrijevica	539,30	1.187,27	476,20	1.048,34	441,50	988,31	445,30	996,80
Dom zdravlja Bar	4.606,50	10.141,22	4.467,80	9.835,87	3.102,50	6.944,94	3.039,00	6.802,81
Dom zdravlja Berane	1.528,40	3.364,77	1.478,40	3.254,70	1.548,80	3.467,00	1.524,80	3.413,26
Dom zdravlja Bijelo Polje	2.560,70	5.637,38	3.067,40	6.752,88	1.962,30	4.392,60	1.692,70	3.789,10
Dom zdravlja Budva	5.792,65	12.752,53	5.999,99	13.209,01	7.115,80	15.928,71	7.178,20	16.068,40
Dom zdravlja Cetinje	1.593,10	3.507,21	1.382,70	3.044,01	2.690,50	6.022,67	3.781,30	8.464,44
Dom zdravlja Danilovgrad	1.653,60	3.640,41	1.305,40	2.873,83	1.489,30	3.333,79	1.534,30	3.434,53
Dom zdravlja Herceg Novi	4.254,80	9.366,96	5.562,30	12.245,38	5.773,10	12.923,10	5.024,50	11.247,34
Dom zdravlja Kolašin	773,50	1.702,86	691,90	1.523,20	693,00	1.551,29	793,10	1.775,33
Dom zdravlja Kotor	2.587,33	5.696,01	3.074,38	6.768,25	2.326,70	5.208,31	2.451,30	5.487,24

Dom zdravlja Mojkovac	1.622,90	3.572,83	926,80	2.040,35	838,20	1.876,41	1.024,60	2.293,56
Dom zdravlja Nikšić	3.562,96	7.843,85	3.606,90	7.940,57	3.625,95	8.116,69	3.512,40	7.862,51
Dom zdravlja Plav	1.631,00	3.590,65	1.662,00	3.658,90	1.286,50	2.879,83	1.119,60	2.506,24
Dom zdravlja Pljevlja	1.829,30	4.027,18	1.668,70	3.673,64	1.351,40	3.025,10	1.452,50	3.251,42
Dom zdravlja Podgorica	29.098,15	64.059,58	22.738,91	50.059,71	15.559,46	34.829,82	16.147,00	36.145,06
Dom zdravlja Rožaje	2.965,40	6.528,34	2.346,10	5.164,96	2.034,50	4.554,24	2.210,20	4.947,53
Dom zdravlja Tivat	1.527,64	3.363,09	1.530,10	3.368,51	1.761,60	3.943,35	1.934,70	4.330,83
Dom zdravlja Ulcinj	1.721,60	3.790,10	1.897,10	4.176,48	2.264,80	5.069,76	2.178,90	4.877,48
Zavod za HMP	5.412,61	11.915,86	4.988,50	10.982,18	4.541,22	10.165,51	4.498,00	10.068,77
Zavod za transfuziju krvi	3.975,70	8.752,50	4.249,20	9.354,61	4.568,50	10.226,59	4.804,70	10.755,33
Opšta bolnica Bar	11.770,90	25.913,62	10.630,85	23.403,82	12.321,50	27.581,67	12.330,10	27.600,94
Opšta bonica Berane	33.833,00	74.483,36	36.389,70	80.111,93	38.554,80	86.304,92	40.610,60	90.906,83
Opšta bolnica Bijelo Polje	9.096,90	20.026,82	8.386,30	18.462,44	10.444,10	23.379,13	10.604,60	23.738,40
Opšta bolnica Cetinje	4.573,00	10.067,46	5.001,40	11.010,56	5.710,70	12.783,39	5.256,10	11.765,80
Opšta bolnica Kotor	9.134,85	20.110,38	8.621,80	18.980,91	8.746,70	19.579,48	9.563,40	21.407,66
Opšta bolnica Nikšić	9.864,03	21.715,67	8.316,63	18.309,06	7.240,98	16.208,95	7.898,20	17.680,13
Opšta bolnica Pljevlja	12.271,00	27.014,59	11.442,60	25.190,89	9.351,40	20.933,11	9.748,00	21.820,90
Spec. Bolnica Brezovik	4.060,76	8.939,76	3.105,60	6.836,98	3.425,10	7.667,08	3.275,30	7.331,76
Spec. Bolnica Dobrota	467,00	1.028,10	336,40	740,59	114,40	256,08	109,10	244,22
Spec. Bolnica Risan	4.272,33	9.405,53	4.648,10	10.232,80	4.192,30	9.384,47	4.440,20	9.939,40
Klinički centar Crne Gore	232.777,80	512.460,31	217.383,80	478.570,44	196.482,40	439.825,87	214.040,40	479.129,43
Institut za javno zdravlje	9.243,23	20.348,97	10.348,45	22.782,11	11.831,07	26.483,86	12.524,92	28.037,03
UKUPNO	**420.601,94**	**925.955,17**	**397.732,41**	**875.607,91**	**373.391,08**	**835.836,03**	**396.748,02**	**888,120.48**

Foto: mzdravlja.gov.me

Prodhuesi më i madhë i mbetjeve mjekësore është Qendra spitalore e cila prodhon mesatarisht prej 200.00 deri në 230.000 kilogram të mbetjeve mjekësore në bazë vjetore. Klinikat private përcjellin të njëjtën procedurë si institucionet shtetërore shëndetësore, shprehen nga Ministria e Shëndetit.

"Ministria e Shëndetit bën evidentimin e sasisë së mbetjeve mjekësore të përpunuara në institucionet private shëndetësore në bazë të dhënave që ofron koncesionari, të cilat për vitin 2019 janë 20.707 kilogram mesatarisht, 1.7 ton në muaj", saktëson ministria.

Ministria e Shëndetit do thotë ka të dhëna të sakta lidhur me sasitë e mbeturinave medicinale të cilat prodhohen në institucionet shtetnore shëndetësore. Mirëpo, informatat nga klinikat private fitohen nga koncesionari "Ekomedike".

Në çfarë mase institucionet private shëndetësore respektojnë dispozitat, nëse kemi parasysh që inspektori për ekologji nga viti 2016 deri sot gjyqeve përkatëse ka dorëzuar shtatë kërkesa për nisjen e procedures kundërvajtëse kundër institucioneve shëndetësore për shkak të përzierjes së mbetjeve mjekësore me ato komunale.

Nga shtatë kërkesa të dorëzuara, gjashtë kanë të bëjnë me institucione private.

Inspeksioni

Drejtorati për Inspektim shprehet se proçedura për kundërvajtje është inicuar për shkak të mosveprimit sipas vendimeve të inspeksionit, lidhur me kontratat e firmosura me "Ekomedika."

"Subjektet në pyetje kanë eliminuar parregullësirat pas inicimit të kërkesave për proçedurat për kundërvajtje, tregohet nga kontrollet shtesë. Institucionet shtetërore dhe private kanë përmirësuar seleksionimin e rregullt në ambalazhin adekuat pas kontrollit në terren. Poashtu, janë konstatuar rritje të sasive të dorëzuara subjektit juridik të autorizuar Ekomedika d.o.o.", thuhet në përgjigjen e Drejtorisë për Inspektime.

Drejtoria për Inspektime përkujton se gjykatësit e gjygjeve përkatëse vendosin për llojin dhe cilësinë e sanksionit dhe shprehjes së dënimt.

"Ligji për menaxhimin e mbeturinave përshkruan se përpunimi, gjegjësisht, asgjësimi i mbeturinave medicinale dhe veterinare mund të bëhet nga shoqëri tregtare apo ndërmarrës nëse ka

pajisjet përgjegjëse, impiantin për përpunimin e mbeturinave medicinale dhe veterinare dhe numrin e duhur të punësuarëve, në bazë të liçencës për përpunim apo për asgjësim të mbeturinave. Rregullorja mbi kushtet, mënyrën dhe proçedurën e përpunimit të mbeturinave medicinale përshkruan kushtet, mënyrën dhe proçedurën e përpunimit të mbeturinave medicinale", shprehen nga Drejtorati për Inspektim.

Dy konkludime mund të nxjerrim nga kjo: institucionet shëndetsore në të shumtën e rasteve nuk respektojnë dispozitat ligjore apo inspeksioni nuk bën mbikqyrje në masë të duhur për të regjistruar të gjitha parregullësirat.

Llojet

Në mbetjet që përpunohen nëpër qendra bëjnë pjesë objektet e mprehta (gjilpërat, kanilat (vigonët), lancetat, bisturitë, shiringat, sharrëzat, konektorët (tubat) e gjilpërave (ageve) për infuzion, stilolapsat e insulinës, shiringat dhe gjilpërat e insulinës, gjilpërat e hemodializës, ampulat e përdorura dhe të dëmtuara dhe flakonët e thyer). Ky lloj i mbeturinave shënohet me kodin 18 01 01.

Grumbullimi dhe asgjësimi i mbetjeve infektive, kodi i të cilave është 18 01 03, u nënshtrohet kërkesave speciale për të parandaluar infektimin. Këto kërkesa të veçanta nuk zbatohen për mbetjet potencialisht infektive që mbajnë kodin 18 01 04 dhe të cilat gjithashtu përpunohen nëpër qendra. Me mbeturinat potencialisht infektive nënkuptohen ndërresat, fasha suvaje, çarçafët, veshjet për përdorim të njëhershëm, pëlhurat, pelenat...

Magazinimi dhe stafi

Mbeturinat e rrezikshme medicinale transportohen te vendi i magazinimit të përkohshëm shpjegon Ministria e Shëndetit.

"Qeset me mbeturina infektive të grumbulluara, të mbyllura dhe të shënuara sipas dispozitave, të futur në kontejner plastikë, transportohen deri te hapësira për depozitim të përkohshëm, së paku njëherë në ditë, sipas mundësisë gjatë një turni", shprehen nga Ministria.

Ato poashtu shprehen se magazinimi i përkohshëm është hapësirë e ndarë ku ruhen mbeturinat medicinale deri sa i dorëzohen kompanisë së autorizuar për marrjen dhe përpunimin, konform ligjit.

"Magazina duhet të ketë madhësi përgjegjëse krahas sasisë së mbeturinave medicinale që prodhohet në atë institucion shëndetësor dhe frekuencës së grumbullimit dhe depozitimit. Hapësira duhet të ketë qasje të lehtë për stafin përgjegjës për menaxhim të mbeturinave, të ketë shenjin për dedikim të hapësirës, të jetë mirë i ndriçuar me ventilim të siguruar natyrorë apo artificial, që ndalon akses personave të paautorizuara", shprehen nga ministria.

Ato shtojn që ka pak incidenta të dalur nga menaxhimi i mbeturinave nga ana e punëtorëve.

Ato shpjegojn se rreth 360 të punësuar në institucionet shëndetsore kanë kaluar programin e menaxhimit me mbeturina medicinale që ka organizuar Ministria e Shëndetit dhe Instituti për Shëndet Publik.

> "Konform Ligjit për mbrojtje dhe shëndet në punë, të punësuarit janë të trajnuar për punë të sigurt në vendet e punës, kanë fituar pajisjet dhe rrobat për mbrojtje personale në punë dhe kryejnë kontrolla të rregullta te specialisti. Numri i incidentave është i ulët dhe nuk ka raste të infektimeve të shënuara të shkaktuara nga gjilpërat, sepse të gjithë rekomandimet dhe proçedurat epidemiologjike lidhur me këtë çështje janë të njohura të gjithë të punësuarëve – thonë nga Ministria.

Nevojat

Ministria e Shëndetësisë shprehet se për momentin nuk sheh nevojë për hapjen e qendrave të reja për përpunimin e mbeturinave.

Vlerësimi i nevojave të Qendrave për përpunimin e mbeturinave është bërë në bazë të vlerësimit të mbeturinave të rrezikshme medicinale, në bazë të dhënave të fituara nga institucionet publike shëndetësore dhe metodave të dalluara me vitin 2011. Ministria gjatë vlerësimit të sasisë ka marrë parasysh tendencën e pritur së rritjes së prodhimtarisë së mbeturinave si rezultat i rritjes ekonomike dhe të standardit.

Përzgjedhja e teknologjisë më të arsyeshme për përpunimin e mbeturinave në nivelin lokal dhe shtetëror është mvarë nga lloji dhe sasia e mbeturinave, largësia mes institucioneve shëndetsore, mundësia e transportit, hapësirës së disponueshme, legjislacionit ekzistues dhe shpenzimeve të menaxhimit,

Ministria thekson se teknologjia është përzgjidhë me qëllim për të zvogëluar ndikimin negativ për shëndet të komunitetit dhe mjedisit, posaçërisht ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, tokës dhe ajrit, të arrihet zvogëlimi i sasisë së mbeturinave të rrezikshme, mundësohet menaxhimi i sigurt me mbeturina brenda dhe jashtë institucioneve shëndetsore.

Drop in qendrat

Drop in qendrat në Podgoricë janë tri me qëllim të punës me përdoruesit e drogave intravenoze, prodhojnë mbeturina infektive medicinale sepse mundësojnë shkëmbimin e materialit steril për injektim.

Ministria e Shëndetit tregon se ekzistojnë rreziqe potenciale nga kontakti me mbeturina infektive – infeksioni HIV, hepatitis B dhe C, infeksione gastroeentrologjike, respiratore dhe të lëkurës.

“Drop in qendrat janë të dalluara si pronarë të mbeturinave medicinale, janë në detyrim që konform Ligjit për Menaxhim të Mbeturinave të udhëheqin evidencë mbi sasitë dhe llojet e mbeturinave. Në Mal të Zi ekzistojnë tri qendra të tilla për përdorues të drogave intravenoze ku përveç shërbimeve tjera bëhen shkëmbime të gjilpërave dhe shpricave. Materiali i tillë i kontaminuar për injektim që grumbollohet në ato qendra (nga terreni dhe në qendrat) grumbullohet në qendra për përpunim të mbeturinave në Podgoricë”, shprehen nga Ministria.

Drop in qendrat, konkludon Ministria e Shëndetit, organizojn punë në terren me qëllim të futjes së kontaktit me varësit të cilët në mënyrë vetiniciative nuk kontaktojn asnjë institucion shëndetësorë dhe social.

Bukovica – krimi pa drejtësi

Pas 16 vjetësh të këtij krimi, dukej se drejtësia më në fund kishte trokitur në derë. Prokurori i lartë i shtetit në Bijello Polje ka paraqitur kërkesë për hetim kundër shtatë personave në çështjen e Bukovicës, nën dyshimin se kanë kryer veprën penale të "krimit kundër njerëzimit". Sa i përket veprimeve hetimore, ato filluan dhe përfunduan me marrjen në pyetje të katër dëshmitarëve. Të shtatë të padituri për krime lufte në Bukovicë u liruan nga akuza për mungesë provash më 31 dhjetor 2010.

Autorët:

Jelena Vukashinoviq

Vuk Vujisiq

Jo shumë kaherë, para 28 viteve ndodhi spastrimi etnik në territorin e Malit të Zi. Grupi i pjesëtarëve të Ushtrisë së Republika Srpskas rrëmbyen disa boshnjakë nga Bukovica dhe i çuan në burgun në Çajniçe për t'i shkëmbyer me ushtarët serbë të zënë rob në Gorazhde. Në atë kohë, tetë vetë u vranë në Bukovicë të Plevlës, me dhjetëra u dërguan në kampe përqendrimi dhe rreth njëqind u dëbuan. Sot, më pak se 200 njerëz jetojnë në këtë vend.

Dhuna brutale dhe forca u ushtrua për t'i shkatërruar njerëzit, shtëpitë dhe bagëtinë e tyre, pasurinë, gjithçka që kishin. Pas torturës së përjetuar, popullata boshnjake filloi të largohej nga Bukovica, pas së cilës shtëpitë e tyre u plaçkitën dhe u shkatërruan.

Përveç formacioneve paraushtarake, policia e atëhershme e Malit të Zi, së bashku me ushtrinë e rregullt, nuk u mbeten "borxh" ish-banorëve të Bukovicës. Dëshmitarët besojnë se ata patën sukses në misionin e tyre të përditshëm për të "pastruar" rajonin përmes bastisjeve dhe keqtrajtimeve të përditshme.

Nga ato kohë kanë mbetur vetëm kujtimet e njerëzve që me sytë e tyre kanë parë keqtrajtimin e familjes së tyre, të afërmve dhe fqinjve. Njëri prej tyre është edhe Ferid Osmanagiq, atëherë nëntëvjeçar, i cili ende kujton me trishtim keqtrajtimet e babait të tij të ndjerë , por edhe zhvendosjen në Plevlë dhe braktisjen e shtëpisë së tij të lindjes.

"Nuk e di nëse ishin policë, nuk mbaj mend, por ata filluan të sulmonin fizikisht babain tim. Për fat të mirë, u shfaq një burrë, drejtori i atëhershëm i Shkollës Fillore "Bratstvo i jedinstvo" (Vëllazërim-Bashkim) Kovaçeviç, i cili e njihte babanë tim dhe e shpëtoi atë nga rrahja. Mbaj mend gjithashtu disa skena të pakëndshme, të shtëna rreth fshatit tim ku jetonim, në mes të ditës. Më kujtohen gjithashtu formacionet paraushtarake që kaluan atje të nesërmen e vrasjes së babait dhe të birit, Hajro dhe Ejub Musliqit. Duke parë se çfarë po ndodhte me të tjerët, unë u frikësova. Unë kisha frikë për babain tim, sepse kryesisht rriheshin disa njerëz që në atë kohë ishin në moshë të pjekur. Ne nuk ishim në gjendje të gjenim emrin e autorit, i cili sulmoi familjen time në ato ditë, por ata ndoshta ishin nga Mali i Zi, sepse shumica e ushtrisë dhe policisë ishin nga Mali i Zi në atë kohë (Plevla, Nikshiqi). Ne erdhëm në Plevlë në dhjetor 1992, te vëllai i babait tim, ku kaluam 6 muajt e ardhshëm. Pas kësaj, ne filluam një jetë të re", tregon Feridi.

„Në atë Bukovicë, nuk do të ketë kurrë lumturi"

Në pyetjen se nëse babai i tij i ndjerë u kthye ndonjëherë në Bukovicë, Feridi thotë se nuk donte dhe se i mban mend mirë fjalët e babait të tij të ndjerë, kur thoshte: **„Në atë Bukovicë, nuk do të ketë kurrë lumturi".** Kjo ishte hera e tij e dytë, që për fat të keq që u desh të largohej nga Bukovica. Ai u largua herën e parë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Feridi thotë se as në Plevlë situata nuk ishte shumë më mirë për t'u ndier të sigurt pas asaj çfarë ndodhi.

"Brenda natës, 5, 6 dyqane private u dogjën, kryesisht të pronarëve myslimanë, arrestime të anëtarëve të partisë së atëhershme SDA, rrahje. As atje jeta nuk ishte e përsosur. Për çfarë arsye kemi zgjedhur Plevlën: së pari, sepse e dinim se kishim strehim të sigurt; arsyeja e dytë është se në atë kohë kishte një numër të madh të myslimanëve në Plevle, 7-8 000 dhe nëse do të ndodhte diçka, ne e dinim se të paktën do të merrej vesh sepse është mjedis urban, ndërsa në Bukovicë situata ishte ndryshe", shpjegon Feridi.

Bastisjet dhe keqtrajtimet me pretekst të kërkimit të armëve

Feridi shton se të gjitha bastisjet ishin nën pretekstin e kërkimit të armëve, megjithëse kjo nuk ishte detyra e ushtrisë dhe e policisë së atëhershme, por për të siguruar kufirin. Ai beson, ashtu si dhe disa ish-banorë të tjerë të Bukovicës, se në fakt detyra e tyre e vërtetë ishte të pastronin zonën përmes së cilës do të ishte e përshtatshme të kontrabandonin armë dhe furnizime për nevojat e Ushtrisë së Republika Srpskas.

Në një nga konventat partiake të vitit 1997, presidenti aktual i Malit të Zi, Millo Gjukanoviq, kryeministër gjatë përndjekjes së banorëve të Bukovicës, pranoi se ai e ndihmoi Republika Srpskan gjatë luftës dhe deklaroi si vijon:

"Le të mos i mbrojë Momir Bullatoviqi serbët nga unë, sepse qeveria që unë drejtoj duhej të ndihmonte fshehtas popullin serb në Hercegovinë dhe Republika Srpska nga Sllobodan Milosheviqi dhe Momir Bulatoviqi për vite me radhë, kur ata vendosën në mënyrë të pashpirtë ta bllokojnë kufirin", tha Gjukanoviqi para mijëra mbështetësve të tij

(https://www.facebook.com/LiberalniSavezCG/posts/2582194028745255)

Interesante është se ekzistonin dëshmi që nuk janë provuar se ish-drejtori i Drejtorisë së Policisë së Malit të Zi, Veselin Veloviq, mori pjesë në bastisjet dhe keqtrajtimin e qytetarëve, në atë kohë si komandant i policisë së Plevlës, e cila e siguronte Bukovicën. Sot Veljoviqi kryen funksionin e këshilltarit për mbrojtje dhe siguri të Presidentit të Malit të Zi, Millo Gjukanoviq.

Në vitin 2019, Veljoviqi u shpreh për CIN (Qendra për Gazetari Hulumtuese) se ai nuk e përjashtonte mundësinë e abuzimit individual të detyrës nga ndonjë polic, por insistonte se policia ishte "faktor i stabilitetit, paqes dhe rendit dhe se ka ndërhyrë në të gjitha rastet ku bastiseshin shtëpitë për shkak të mbajtjes pa leje të armëve ose në lidhje me raportimin e veprave të tjera penale të kryera.

"Askush nga policët që kanë marrë pjesë në ato bastisje nuk i rrahën, abuzuan dhe i keqtrajtuan njerëzit, shtëpitë dhe objektet e të cilëve u bastisën, sepse askush nga banorët e Bukovicës nuk më është ankuar për punën dhe sjelljen e policëve të akuzuar... Për policinë është e qartë që S.H. u vetëvarur, por jo nga frika ose sepse ishte rrahur nga ushtria dhe policia, por për arsye të njohura vetëm për të", ka thënë Veljoviqi në atë kohë.

Ne pyetëm Hazbija Kalaçin, kryetar i Partisë së Drejtësisë dhe Pajtimit, se si e komenton mos-ndjekjen penale të personave përgjegjës për krimin, por gjithashtu rolin dhe përgjeg-

jësinë e ish-drejtorit të policisë Veselin Veljoviq në persekutimin e boshnjakëve nga Bukovica, por edhe më vonë në ndjekjen penale të personave përgjegjës.

"A keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë shembull, ku personi përgjegjës për një krim ndjek vetveten? Është iluzore dhe naive të prisni që autorët e spastrimit etnik të procesuojnë vetveten. Nuk bëhet fjalë vetëm për rastin e Bukovicës, por edhe me sulmet terroriste dhe okupimin e Plevlës, dëbimin e refugjatëve nga Bosnja dhe Hercegovina, arrestimin dhe torturimin e përfaqësuesve politikë boshnjakë në Mal të Zi dhe shumë krime të tjera nga ajo kohë", përgjigjet Kallaç dhe shton se Veloviq është vetëm një nga përgjegjësit në zinxhirin komandues.

"Ai është vetëm prej tyre. Filip Vujanoviqi ishte ministër i Drejtësisë në atë kohë, Millo Gjukanoviq ishte epror i Veljoviqit dhe Vujanoviqit. Veselin Veljoviq ishte komandanti i policisë speciale që ishte e angazhuar në Bukovicë në atë kohë. Ka shumë dëshmi për torturat e policisë malazeze kundër banorëve të Bukovicës, ku ndër të tjera, Veljoviq akuzohet drejtpërdrejt për tortura. Pyetja më e saktë është se si pozicioni i tij i mëparshëm kontribuoi në relativizimin dhe fshehjen e krimeve", thotë Hazbija Kallaç.

Kthimi pa drejtësi është i pamundur

Në periudhën nga viti 2007 deri më sot, Qeveria e Malit të Zi ka ndërtuar 108 objekte banimi montazh dhe rreth shtatëdhjetë objekte ndihmëse si pjesë e projektit të rindërtimit të Bukovicës. Vlera totale e projektit ishte rreth katër milionë e gjysmë euro.

- Shtëpitë janë ndërtuar dhe kjo qëndron, është në rregull. Sidoqoftë, sipas mendimit tim si dhe shumë të tjerëve, projekti është punuar gabimisht. Qeveria ka vlerësuar se ndërtimi i këtyre shtëpive do të zgjidhte gjithçka. Megjithatë, kur e shikoni infrastrukturën rrugore të Bukovicës, ajo është në gjendje të mjerueshme. Kur shikoni furnizimin me energji elektrike, me borën e parë ose një erë më të fortë, e gjithë Bukovica mbetet pa energji elektrike. Shikoni rrjetin celular. Shumë vështirë është të kesh sinjal atje. Kjo duhet të ishte bërë së pari dhe të mblidheshin të gjithë njerëzit që janë të gatshëm të kthehen atje - shpjegon Ferid Osmanagiqi.

Feridi theksoi se, pas kaq shumë vitesh, nuk mund të presim nga njerëzit të kthehen menjëherë.

- Pas vitit 1992, të gjithë kanë ikur dhe të gjithë kanë filluar jetë të re. Disa gjenerata të reja kanë dalë. Ata nuk mund të prisnin që njerëzit të ktheheshin vetëm për shkak të shtëpive të tyre - tha ai.

Pas 16 vjetësh të këtij krimi, dukej se drejtësia më në fund kishte trokitur në derë. Prokurori i lartë i shtetit në Bijello Pole kërkoi kryerjen e hetimit kundër shtatë personave në rastin „Bukovica“, për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale të “krimit kundër njerëzimit”. Sa i përket veprimeve hetimore, ato filluan dhe përfunduan me marrjen në pyetje të katër dëshmitarëve. Të shtatë të paditurit për krime lufte në Bukovicë u liruan nga akuza për mungesë provash, më 31 dhjetor 2010.

Hazbija Kalaç beson se ish-qeveria nuk e zbatoi sinqerisht programin për kthimin e banorëve të Bukovicës, sepse ata që ishin përgjegjës nuk u ndëshkuan dhe banorëve nuk u siguruan kushtet themelore të jetesës.

“Urdhërdhënësit dhe autorët e krimeve nuk u ndëshkuan, madje nuk u emëruan, kështu që u krijuan parakushtet që kthimi i të dëbuarve të mos ndodhë kurrë. Përsëri e realizuar me plan. Viktimat janë manipuluar gjatë gjithë këtyre viteve, u është bërë presion shtesë për t’u kënaqur me shtëpitë që shteti ka ndërtuar për ta. Ndërtimi i shtëpive pa infrastrukturë shtesë dhe mbështetje shtesë, pagesa e dëmshpërblimeve të caktuara monetare për të dëmtuarit, si konfirmim i drejtpërdrejtë i përgjegjësisë së shtetit për krimet, shoqëruar me mbrojtjen e pamaskuar të kriminelëve, paraqet shembull shkollor për legalizimin e krimit të spastrimit etnik “.

Cila është rruga për ringjalljen e Bukovicës dhe kthimin e popullsisë së saj?

Hazbija Kalaç beson se është e mundur, nëse ka vullnet politik, që familjet e larguara të kthehen, ata që janë përgjegjës të ndëshkohen dhe fshatrat të ringjallen në këtë mënyrë:

“Urdhërdhënësit dhe ekzekutorët të nxirren para drejtësisë dhe të ndëshkohen në mënyrë adekuate. Bukovica të trajtohet si një zonë me interes të veçantë për shtetin duke ndërtuar infrastrukturën, banorëve që dëshirojnë të kthehen t’u sigurohet mbështetja shtetërore për krijimin e fermave, bizneseve të vogla, lirimi nga tatimet, taksat... Ka shumë modalitete si shteti mund të nxisë kthimin në këtë zonë jashtëzakonisht të pasur me burime. Por mbi të gjitha, personat përgjegjës për krimet duhet të dënohen. Ky është parakusht për gjithçka”, pohon Hazbija Kalaç.

Megjithatë, Ferid Osmanagiq nuk është optimist. Ai nuk beson se shteti do të bëjë gjë për të ndryshuar gjërat, sepse ka mungesë të vullnetit politik.

“Viktimat dhe familjet kanë humbur besimin në shtetin dhe drejtësinë, sepse është e vështirë tani, pas kaq shumë vitesh, të ndiqen penalisht ata që janë përgjegjës. Shumë viktima, dëshmitarë dhe autorë nuk janë më në këtë botë, kështu që sa më shumë kalon koha është më e vështirë të presësh që drejtësia të arrijë te përgjegjësit“, mendon Feridi.

Për Bukovicën pak flitet dhe dihet

Shpesh dëgjojmë në publik histori për krime të ndodhura jashtë Malit të Zi, ndërsa shumë nuk kanë dëgjuar për Bukovicën. Shkaku, thonë bashkëbiseduesit tanë, është në fshehjen e krimeve, sepse ato përmenden rrallë.

Feridi thotë se 98% e të rinjve nga Plevla nuk dinë asgjë për Bukovicën, ndërsa situata me të moshuarit është disi më e mirë, por përsëri shumica nuk i dinë detajet e krimit.

Në pyetjen nëse mendon se flitet shumë më tepër për krime të tjera jashtë Malit të Zi, ndërsa nuk flitet për Bukovicën, Kallaç ka thënë se kjo është e vërtetë.

„Srebrenica, plaga më e madhe boshnjake, emëruesi ynë për gjenocidet që na kanë ndodhur në 150 vitet e fundit, është simbol i vuajtjes sonë, por fatkeqësisht ajo plagë filloi të keqpërdoret për qëllime politike ditore nga njëra anë dhe duke devijuar fokusin e publikut nga krimet në Malin e Zi. Nuk është normale ose morale të heshtësh për krimet, viktima të të cilëve janë bashkëqytetarët, fqinjët, bashkatdhetarët dhe të merresh me Srebrenicën çdo të dytën ose të tretën ditë. Bukovica është gjithashtu Srebrenica jonë. Në vitin 1943, hordhitë çetnike të drejtuara nga Pavle Gjurishiqi vranë rreth 8,000 civilë të moshuar, gra dhe fëmijë brenda një muaji, ndër të tjera po në atë zonë, nga të cilët 26% e viktimave ishin fëmijë nën 4 vjeç. Pra, kjo është Srebrenica jonë, e cila ndodhi në vitet 1942 dhe 1943 të shekullit të kaluar dhe që kryesisht mbeti pa u

ndëshkuar. Kjo është arsyeja pse na ndodhi Bukovica në vitin 1992 dhe 1993. Kjo është arsyeja pse ne kemi detyrim si popull dhe shoqëri që së pari të pastrojmë mbeturinat nga oborri ynë», përfundon Kallaç.

Në anën tjetër, Feridi beson se Bukovica dhe krimet e tjera duhet të futen në librat shkollorë në mënyrë që të mos harrohen, e kështu as të mos përsëriten.

Përpos bashkëbiseduesve tanë, kemi kontaktuar edhe me Partinë Boshnjake, së cilës i kemi dërguar të njëjtat pyetje si Partisë së Drejtësisë dhe Pajtimit. Mirëpo, përkundër përkujtesës dhe premtimit se do të përgjigjen, as pas 20 ditësh nuk kemi fituar përgjigje në pyetjet tona. I kemi shkruar edhe Veloviqit, i cili na ka drejtuar që t'u referohemi deklaratave të dokumentuara që ai i ka dhënë më herët lidhur me rastin e Bukovicës.

SHFAROSJA E SPECIEVE TË EGRA TË KAFSHËVE NË MAL TË ZI

Rrëqebulli ballkanik: Macja së cilës ne ia premë rrugën

Fejsbuku është i mbushur me profilet e gjuetarëve (të ligjshëm) dhe atyre të paligjshëm, të cilët shpesh në mënyrë të pamatur lavdërohen me prenë, edhe atëherë kur s'është ditë e paraparë për gjueti, madje as sezon i gjuetisë. Paditë e dërguara mbeten në sirtarë, ose nuk procedohen në mënyrë adekuate. Aktgjykimet s'janë lehtësisht të arritshme. Duket se Ligji funksionon vetëm në letër. Njerëzit të cilët veprojnë jashtë institucioneve dhe të cilët s'varen nga buxheti shtetëror, në mënyrë transparente e transmetojnë gjendjen reale. Aty s'ka informata të përmbajtura, hulumtime të shpikura ose përgjigje diplomatike që s'na thonë asgjë.

Autorët:

Jelena Vukashinoviq

A e dini tregimin për macen e Shrëdingerit? Eksperimentin, në formë marifeti mendor, e krijoi fizikanti i njohur gjerman **Ervin Shrëdinger** për të "provuar" se a është macja, pas një sërë ngjarjesh, gjallë apo e vdekur. A ekziston ajo në ndonjë hapësirë apo jo.

Ky paradoks i njohur mund të quhej lirisht edhe rrëqebulli ballkanik i Shrëdingerit. Sidomos në Mal të Zi. Drejtoria për Pylltari dhe Gjueti pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Federata e Gjuetisë pohojnë se ai ekziston në hapësirën e Malit të Zi. Mirëpo, Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Shpendëve dhe OJQ "Wildlife Montenegro" thonë se situata është pak më ndryshe.

Kafshë e rrallë edhe në të kaluarën...

Për rrëqebullin ballkanik dihet me vërtetësi se, edhe pse i rrallë, ekzistonte në Mal të Zi. **Pavle Rovinski**, historiani rus i cili një pjesë të mirë të jetës së tij e kaloi në Mal të Zi (shekulli 19), thoshte se gjatë gjuetisë "nganjëherë haset edhe rrëqebulli", gjegjësisht se "haset shumë rrallë rrëqebulli". **Fireri**, ornitologu i parë, hulumtues nga Austria, përmend se trashëgimtari i fronit **Danilo, i cili erdhi pas vdekjes së mbretit Nikola**, në pallatin mbretëror të Cetinës ia tregoi gëzofin e rrëqebullit të gjuajtur në vitin 1890 në Sutorman, ndërsa në një gjueti mbretërore, në nëntor të vitit 1894 në malin Bjellasicë, në të cilën mori pjesë edhe ai, përveç egërsirave të tjera, u vra edhe një "ekzemplar i fortë" i rrëqebullit. Edhe etnologu serb, **Jovan Erdeloviq**, thekson se në zonën Bratonozhiq në të kaluarën po ashtu ekzistonin rrëqebujt.

Realiteti i vrazhdë i rrëqebullit ballkanik

Rrëqebulli ballkanik është nënlloji më i pakët në numër i rrëqebullit evro-aziatik. Mu për shkak të numrit të vogël dhe rrezikut të madh nga zhdukja, kjo specie gjendet në Listën e Kuqe IUCN **(lista globale me të dhënat për statusin e specieve të rrezikuara).**

Fotografi 1. Rrëqebulli ballkanik, fotografoi Dime Melovski (MES - Macedonian Ecological Society)

Sot prania e rrëqebullit ballkanik tek ne regjistrohet vetëm në zonat kufitare dhe atë shumë rrallë. Siç thonë nga Organizata Joqeveritare "Wildlife Montenegro", ky fakt s'meriton lëvdatë.

"Meqë bëhet fjalë për kafshën së cilës i nevojitet hapësirë e madhe, duke menduar këtu për individin dhe territorin e tij, si shtet i vogël kurrsesi s'mund të vështrojmë nga këndi kombëtar, sepse ne jemi vetëm një pjesë e vogël e popullatës së përgjithshme për të cilën tashmë dihet se është e vogël. Bëhet fjalë për specien, popullata e së cilës u reduktua në vetëm rreth 50 individë të rritur. Kur bëhet fjalë për faktorët e rrezikut, për rrëqebullin ballkanik ato janë qartë të përcaktuara: madhësia e vogël e popullatës natyrore, disponueshmëria e kufizuar e presë dhe degradimi i habitateve dhe gjuetia e paligjshme", thanë nga kjo OJQ.

Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Shpendëve (QMHSh) në periudhën nga nëntori i vitit 2014 deri në qershor të vitit 2018, në zonën e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", si dhe në zonën kufitare në mes Malit të Zi dhe Kosovës, dhe Malit të Zi dhe Shqipërisë, ka kryer katër sezone të pavarura të monitorimit të rrëqebullit ballkanik përmes foto-kurtheve. Gjatë çdo sezoni, pozita e foto-kurtheve u ndryshua në koordinim me kolegët nga Kosova dhe Shqipëria. Për fat të keq, gjatë tërë periudhës së monitorimit, në Mal të Zi nuk u vërtetua prania e rrëqebullit ballkanik.

Fotografi 2. Biologu Aleksandar Peroviq nga QMHSh-ja në terren vendos foto-kurthet për të vërtetuar se a është i pranishëm rrëqebulli ballkanik

Fotografi 3. Foto – kurthi i pozicionuar për të regjistruar rrëqebullin ballkanik

Nga Drejtoria për Pylltari dhe Gjueti mohojnë se rrëqebulli ballkanik është shfarosur tek ne dhe thonë se habitatet e tij gjenden në Bjeshkët e Nemuna dhe në Hajlë.

"Hulumtimet e kryera pak kohë më parë me partnerët ndërkombëtarë (EuroNatur, Instituti Norvegjez për Hulumtimin e Natyrës, Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), Komisioni për Ruajtjen e Specieve (SSC) të Mishngrënësve të Mëdhenj) tregojnë për ekzistencën e kësaj specie në Bjeshkët e Nemuna dhe në Hajlë, gjë që flet në favor të faktit se ne me masat sistematike, para së gjithash me miratimin e Ligjit për Armë, në masën më të madhe kemi parandaluar të gjitha aktivitetet destruktive ndaj faunës së egër", thanë nga Drejtoria.

Mirëpo, **Aleksandar Peroviq**, biolog i diplomuar – mamolog nga QMHSh-ja, i cili e udhëhoqi këtë hulumtim në zonën e Malit të Zi, tha se nuk qëndron konstatimi se prania e rrëqebullit u vërtetua në territorin e Hajlës, si në anën malazeze, ashtu edhe në atë kosovare.

"Ky lajm u publikua në formë sensacionale në media dhe asnjëherë nuk u dëshmua me prova. Për hir të së vërtetës, në territorin e Kosovës, përmes foto-kurtheve, u vërtetua prania e një rrëqebulli ballkanik në malin Sharr, nëna me të vegjlit në afërsi të Deçanit dhe një në zonën e Bogës, e cila graviton kah Mali i Zi. Ekziston mundësia që një pjesë e vogël e territorit, të cilin e mban ky individ, është edhe në Mal të Zi, por kjo gjë nuk u vërtetua zyrtarisht", tha Peroviq.

Fotografi 4. Skuadra e QMHSh-së bisedon me popullatën lokale

Edhe në Federatën e Gjuetisë së Malit të Zi, në bazë të të dhënave në dispozicion, regjistrohet prania e rrëqebullit.

"Ekzistojnë zonat e pranisë së tij të përhershme dhe zonat ku qëndron përkohësisht. Për numrin e tij në Mal të Zi s'mund të flasim me siguri të plotë, por mund të konfirmojmë se bëhet fjalë për ekzemplarë të rrallë dhe se numri i tyre është tejet i vogël", thanë nga Federata e Gjuetisë.

Të nxitur nga ky konstatim, nga OJQ "WildLife" pyetën përse institucionet s'po bëjnë asgjë për ta rritur numrin e tyre.

"Nëse përfundimi është se numri është i vogël, përse institucionet nuk ndërmarrin asgjë që të krijohen kushtet për rritjen e numrit të kësaj specieje, gjegjësisht të ofrohen kushtet elementare ekologjike në të cilat kjo kafshë do të shumëzohej (paqja, habitatet

dhe sasia e mjaftueshme e ushqimit). Propozojmë që të fillohet nga legjislacioni juridik, sepse sa kujdesemi për të ardhmen e kësaj specieje flet edhe fakti se ajo nuk u njoh nga Ligji për Gjuetinë, e as nuk bën pjesë në Listën e Llojeve të Kafshëve të Mbrojtura nga Ligji", thanë nga Wildlife Montenegro.

Me gjueti të paligjshme deri tek zhdukja e egërsirave

Ashtu si për rrëqebullin, gjuetia e paligjshme është faktor i rrezikut edhe për të gjitha egërsirat tjera.

Derisa nga Drejtoria thonë se gjuetia e paligjshme është e pranishme në mënyrë sporadike në terrenet e gjuetisë në Mal të Zi dhe se s'është e pranishme në masën e cila do të rrezikonte ekzistencën e cilitdo lloj të egërsirave që lirshëm jetojnë në natyrë, nga OJQ "Wildlife" pohojnë se për shkak të presionit nga gjuetia vjen deri te shuarja lokale ose shfaqja shumë e dobët e kaprollit dhe e dhisë së egër në disa zona ku pritet të jenë në numër më të madh.



Fotografi 5. Rezultati i foto-kurthit. Burimi: Qendra për Mbrojtjen dhe Hulumtimin e Shpendëve

"Këto specie janë ushqimi bazë i egërsirave të mëdha (që, për shembull, është bazë për mbijetesën e rrëqebullit). Mali i Zi nuk e zotëron librin e kuq të faunës, prandaj vazhdojmë t'i përmbahemi legjislacionit ndërkombëtar dhe mendimeve profesionale. Me

hulumtimin e shpërndarjes historike të disa specieve të cilat ishin objekt i gjuetisë, fare lehtë mund të arrihet përfundimi se paligjshmëria nga e kaluara (deri në mesin e shekullit 20) shkaktoi kanosjen e tyre, jo vetëm në Mal të Zi, por edhe në Ballkan. Ekzistojnë, për shembull, të dhënat për praninë e rrëqebullit para 300 vitesh në Llovqen ose në Bratonozhiq. Tani ato janë habitate shumë të ndryshuara dhe nuk janë të përshtatshme për këtë lloj", thanë nga Wildlife Montenegro.

Nga Federata e Gjuetisë thanë se si në çdo veprimtari tjetër ka kundërvajtës dhe se gjuetia e paligjshme është e pranishme, por jo në atë masë sa të rrezikojë cilëndo egërsirë, objekt të gjuetisë, në Mal të Zi.

Numri i kafshëve të egra fisnike në pikëpyetje?

Kur flasim për rritjen e pranisë së kafshëve të egra fisnike në territorin e Malit të Zi, nga OJQ "WildLife" thanë se për këtë çështje askush në Mal të Zi s'ka përgjigje të saktë.

"Asnjëherë në historinë e Malit të Zi s'është bërë monitorimi i cilësdo specie të gjitarëve në nivel kombëtar. Vetëm atëherë kur të bëhet numërimi sipas metodave të caktuara, në periudhën nga tre deri në pesë vite, mund të jepet përgjigjja e qartë në këtë pyetje", thanë ata.

Fotografi 6. Rezultati i foto-kurthit. Burimi: CZIP

Nga ana tjetër, nga Ministria e Bujqësisë dhe Federata e Gjuetisë së Malit të Zi pohojnë se po rritet numri i kafshëve të egra fisnike, edhe pse s'thanë se si arritën deri te ky përfundim.

„Në periudhën paraprake, përmes mjeteve të informimit, opinioni i gjerë kishte mundësi të informohet se numri i kafshëve të egra (në veçanti i atyre fisnike) po rritet në tërë territorin e Malit të Zi. Theksojmë se kjo ministri gjatë dhënies së pëlqimit për Planet Vjetore të Gjuetisë, të cilat i zbatojnë shfrytëzuesit e terreneve të gjuetisë, ndan kuotat minimale për gjuetinë e disa specieve dhe atë kryesisht të dëmtuesve", shpjegojnë ata.

Federata e Gjuetisë thotë se rezultat i punës së palodhshme në gjueti është rritja evidente e numrit të specieve të kultivuara të kafshëve të egra në terrenet e gjuetisë në Mal të Zi: kaprolli, dhia e egër, ariu, thiu i egër, lepuri dhe thëllëza...

"Dhe të gjitha specieve tjera, që u vërtetua edhe nga ekspertët evropianë nga fusha e gjuetisë, biologjisë dhe veterinës në takimet e mbajtura gjatë qëndrimit të tyre në Mal të Zi", kumtuan ata.

Prapë s'kemi emra dhe njerëz konkretë që qëndrojnë pas këtyre hulumtimeve. Federata e Gjuetisë së Malit të Zi s'ka problem që të thirret në ekspertët evropianë, të cilët gjoja i vërtetuan këto qëndrime, por ka problem të tregojë se kush janë këta njerëz me emër dhe mbiemër. Përgjigjen në këtë pyetje nuk e kanë dhënë.

Paditë penale për gjueti të paligjshme

Në bazë të informatave me të cilat disponon **Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural**, në periudhën e kaluar pesëvjeçare janë ngritur 60 padi penale, 56 procese të kundërvajtjes dhe u iniciuan 69 procese disiplinore ndaj anëtarëve të shoqatave të gjuetisë.

"Nga gjykatat dhe shfrytëzuesit e terreneve të gjuetisë nuk i fituam informatat për epilogun e tyre", thanë nga Ministria.

Nga Federata e Gjuetisë së Malit të Zi u ngritën në tre vitet e fundit të gjuetisë 55 padi penale, 41 padi të kundërvajtjes dhe 43 dënime disiplinore, ndërsa epilogu i këtyre padive është i njohur për gjykatat kompetente dhe shfrytëzuesit e terreneve të gjuetisë.

Zyrtarët e policisë në pesë vitet e fundit ngritën 52 padi penale, sipas neneve 325 dhe 326 të Kodit Penal të Malit të Zi.

QENDRAT E SIGURISË	2016	2017	2018	2019	2020	UKUPNO
Podgoricë	8	12	9	5	6	40
Nikshiq	0	1	0	0	2	3
Bijello Pole	0	0	3	0	1	4
Tivar	0	0	0	0	0	0
Beran	0	0	0	0	0	0
Budvë	0	0	0	0	0	0
Plevlë	0	0	0	0	0	0
Herceg Novi	0	0	0	0	1	1

Inspektorati për Pylltari, Gjueti dhe Mbrojtjen e Bimëve, për periudhën 2017, 2018, 2019 dhe për gjashtë muajt e parë të vitit 2020, kreu gjithsej 898 inspektime, përkatësisht kontrolle inspektuese nga fusha e gjuetisë, pastaj për mënjanimin e parregullsive shprehu masën këshilluese në 59 raste dhe solli 15 vendime.

Për mosrespektimin e Ligjit për Egërsira dhe Gjueti, gjatë periudhës raportuese, lëshoi 24 urdhëresa për kundërvajtje me vlerë prej 4.600.000 euro, ia dorëzoi gjykatave kompetente 22 kërkesa për inicimin e procesit të kundërvajtjes dhe dorëzoi gjashtë padi penale për gjuetinë e paligjshme, si dhe sekuestroi 50 thëllëza.

Përveç aktiviteteve të rregullta ky inspektorat ka kryer inspektimin edhe sipas iniciativave, të cilat më së shumti buronin nga OJQ-të dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural, pastaj nga personat fizikë dhe më së paku nga Federata e Gjuetisë së Malit të Zi.

Duke ndjekur rrugën e padive penale, stacioni i fundit dhe ndoshta më i rëndësishmi është prokuroria dhe gjykata, të cilët, për shkak të COVID-19, më drejtuan në faqet e tyre të internetit, të cilat s'punojnë.

E vërteta dhe e pavërteta

Natyra është shembull tejet i mirë se çdo gjë është e lidhur njëra me tjetrën. Cilësinë më të mirë të jetës së njeriut në masë të madhe "e mundëson" natyra, ndërsa për cilësinë

e natyrës flet më së miri bota bimore dhe shtazore në të. Shumëllojshmëria siguron stabilitetin e ekosistemit, e si rrjedhojë edhe mbijetesën tonë. Sot kemi rastin kur, si pasojë e zhdukjes së habitateve, gjuetisë së paligjshme dhe gjuetisë, bota e kafshëve të egra është në gjendje shumë të mjerë. Sipas Fondit Botëror për Mbrojtjen e Natyrës (WWF), "Raporti mbi jetën në planet" për vitin 2020 tregon se gjatë 46 viteve (1970 - 2016) erdhi deri tek rënia e frikshme e popullatës së kafshëve në masën 68 %.

Ne në Mal të Zi, siç duket, s'jemi shumë të brengosur nga këto të dhëna, sepse siç thonë institucionet, të dhënat tona flasin ndryshe. Dhe derisa duket që çdo gjë është në rregull, çdo ditë jemi dëshmitarë të numrit gjithnjë e më të vogël të egërsirave, madje edhe të atyre fisnike. Rrjeti social Facebook është i mbushur me profilet e gjuetarëve të ligjshëm dhe atyre të paligjshëm, të cilët shpesh në mënyrë të pamatur lavdërohen me prenë, edhe atëherë kur s'është ditë e paraparë për gjueti, madje as sezon i gjuetisë. Paditë e dërguara mbeten në sirtarë, ose nuk procedohen në mënyrë adekuate. Aktgjykimet s'janë lehtësisht të arritshme. Duket se Ligji funksionon vetëm në letër. Njerëzit të cilët veprojnë jashtë institucioneve dhe të cilët nuk varen nga buxheti shtetëror, në mënyrë transparente e transmetojnë gjendjen reale. Aty s'ka informata të përmbajtura, hulumtime të shpikura ose përgjigje diplomatike që s'na thonë asgjë.

Për ta ruajtur planetin Tokë dhe jetën tonë në të, duhet të bëhemi të vetëdijshëm se pa diversitetin biologjik një gjë e tillë është e pamundur. Dhe nëse na mungon vetëdija për faktin se kafshës së egër i takon liria dhe habitati të cilin e banon, që kujdesin për ruajtjen e biodiversitetit s'ua kemi borxh, por është obligim i yni, atëherë hajde të mendojmë për gjeneratat e ardhshme të cilave do t'ua lëmë amanet këtë tokë.

Është dëm edhe për Malin e Zi po ashtu që nuk e ka një kafshë të tillë, siç është, për shembull, rrëqebulli ballkanik, sepse habitatet që ai i banon, ne i kemi. Na mbetet vetëm të konkludojmë se na vjen keq që kësaj maceje ne ia premë rrugën.

PËRFAQËSUESIT E DELEGACIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PUSHTETIT, OPOZITËS DHE SEKTORIT JOQEVERITAT MBI PLOTËSIMIN E KRITEREVE PËR KAPITUJT 23 DHE 24

Përparimi në sundimin e ligjit është jetik

Autorët:

Milica Lipovac

Violeta Hajrizaj

Mali i Zi është vendi më i përparuar në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), sidoqoftë ende duhet të plotësojë kriteret e përkohshme të përcaktuara në Kapitujt 23 dhe 24 mbi sundimin e ligjit, kanë vlerësuar nga **Delegacioni i BE-së në Mal të Zi**.

Njëkohësisht, ndërsa qeveria vlerëson se vullneti politik është thelbësor në përmbushjen e kritereve nga kapitujt 23 dhe 24 dhe se nuk do të ketë progres pa to, opozita thotë se situata në gjyqësor ndikon në përmbushjen e detyrimeve nga këto dy kapituj, në sektorin civil vlerësojnë se Mali Zi nuk është as afër mbylljes së kapitujve 23 dhe 24.

„Përparimi në sundimin e ligjit është me rëndësi jetike, sepse mbështet të gjitha përpjekjet e tjera për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe për të inkurajuar rritjen ekonomike“, thanë në Delegacionin e BE-së.

Siç thanë ata, përparimi në këto fusha është me rëndësi thelbësore për përparimin e mëtejshëm në negociata, që është njohur edhe nga metodologjia e re e zgjerimit që Mali i Zi e ka pranuar vitin e kaluar.

„Nevojiten më shumë rezultate në fushat kryesore kritike të mbetura, të tilla si liria e medias, lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, si dhe një angazhim i ri për reformën gjyqësore. Shteti duhet të përqendrohet në 'bazat' e procesit të zgjerimit: funksionimin e institucioneve demokratike, reformën e administratës publike dhe qeverisjen ekonomike. Sundimi i ligjit mbetet prioriteti kryesor në rrugën e Malit të Zi drejt Bashkimit Evropian, ku pika kryesore është përmbushja e standardeve të përkohshme në sundimin e ligjit në kapitujt 23 dhe 24“, thanë nga Delegacioni i BE-së.

Ata deklaruan se asnjë kapitull tjetër negociues nuk mund të mbyllet para se të arrihet kjo.

Siç thanë ata, paralelisht, duhet të bëhen përpjekje për të zhvilluar një ekonomi funksionale të tregut dhe për të përmirësuar aftësinë konkurruese dhe rritjen afatgjatë të ekonomisë malazeze duke mbështetur reformat kryesore strukturore.

“Sistemi gjyqësor efikas është i një rëndësie të madhe për funksionimin e shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e lirive themelore. Megjithëse Mali i Zi është mesatarisht i përgatitur në këtë fushë, sfida të caktuara mbeten, veçanërisht përsa i përket profesionalizmit, efikasitetit dhe përgjegjësisë së gjyqësorit. Shteti duhet të përmbush rekomandimet të Grupit të Shteteve në Kundër Korrupsionit (GRECO) mbi pavarësinë e gjyqësorit. Është e domosdoshme që Mali i Zi të mos çalojnë kundrejt arritjeve të mëparshme në reformën e gjyqësorit dhe të vazhdojë të ndërtojë mbi përparimin e arritur në vitet e fundit“, thanë në Delegacionin e BE-së.

Ata shtuan se raporti vjetor i Komisionit Evropian, i publikuar në tetor të vitit të kaluar, ofron orientime të hollësishme se si ta arrijmë atë.

„Të gjitha forcat politike pro-evropiane tani kanë mundësinë të provojnë angazhimin e tyre të vërtetë për të ardhmen evropiane të Malit të Zi“, thanë në Delegacionin e BE-së.

Sipas tyre, mënyra më e mirë për ta bërë këtë është të punohet së bashku për çështje me interes kombëtar, siç janë rimëkëmbja ekonomike nga COVID-19, reformat gjithëpërfshirëse zgjedhore dhe emërimet e pazgjidhura në pozicionet kyçe gjyqësore dhe prokuroriale.

Nga Delegacioni thanë se qytetarët tashmë e ndiejnë shumë fort se Mali Zi e ka vendin në BE - sipas anketimit të fundit të opinionit publik, të kryer nga agjencia DeFacto, 74.8 për qind e të anketuarve mbështesin anëtarësimin e vendit të tyre në BE.

„Është e qartë se tani është koha që të gjitha palët e interesuara të punojnë së bashku për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet e tyre dhe për të përshpejtuar reformat politike dhe ekonomike të nevojshme për përafrimin e Malit të Zi më pranë Bashkimit Evropian", konkluduan në Delegacionin e BE-së.

Anëtarja e Komisionit Parlamentar për Integrim Evropian nga Fronti Demokratik, Simonida Kordiq, vlerësoi se vullneti politik është thelbësor në përmbushjen e kritereve nga kapitujt 23 dhe 24, pa të cilin nuk do të ketë përparim dhe shtoi se situata në sistemin gjyqësor është një nga ankesat (vërejtjet) kryesore në arritjen e standardeve nga këto dy kapituj kryesorë.

Simonida Kordić

Kordiq tha se legjislacioni pozitiv përcakton procedurën për zgjedhjen e anëtarëve të organeve gjyqësore, e cila kërkon një shumicë parlamentare të kualifikuar, e cila në situ-

atën aktuale në parlament duhet të përbëhet nga përfaqësues të qeverisë dhe përfaqësues të opozitës.

„Ky është ndoshta shembulli më i mirë i domosdoshmërisë së ekzistencës së vullnetit politik për të zgjidhur çështje problematike, të tilla si funksionimi ligjor i sistemit gjyqësor. Nëse do të ekzistonte vullneti i tillë, edhe ky problem mund të eliminohet. Përndryshe, nëse nuk ndodh kjo, do të jetë krejtësisht e qartë se kush angazhohet me të vërtetë në përparimin e shoqërisë sonë drejt anëtarësimit në BE dhe për kë është thjesht marketing, pas të cilit fshihen interesa dhe qëllime të tjera“, konsideron Kordiq.

Ajo shton se përkundër përvojës famëkeqe në drejtim të bashkëpunimit politik ndër-partiak, ajo ende pret që do të ketë mjaft përfaqësues të zgjedhur të popullit të përgjegjshëm që do të njohin interesin universal të të gjithë qytetarëve për të jetuar në një shtet të qëndrueshëm, të rregullt, në të cilin institucionet funksionojnë, i cili është pjesë e hapësirës politike dhe, çfarë është ndoshta edhe më e rëndësishme, ekonomike evropiane.

„Çdo hap vendimtar i Qeverisë që synon vendosjen e sundimit të ligjit, një shoqëri më të drejtë dhe më të lirë, një shoqëri në të cilën gazetarët nuk arrestohen por kriminelët, në të cilën buxheti i shtetit ndihmon grupe të prekura, jo zyrtarë të partisë, në të cilin shërbimet e sigurisë punojnë për sigurinë e shtetit, jo të partisë në pushtet, do të njihen dhe mirëpriten nga BE dhe do të jenë vendimtare për përshpejtimin e procesit të negociatave dhe hyrjen përfundimtare të Malit të Zi në BE. Përmbushja e standardeve dhe kritereve nga kapitujt 23 dhe 24 janë thelbësore për t'u bërë pjesë e BE-së. Tani për tani, ky bllokim, për sa i përket Malit të Zi, është ende i fortë“, tha Kordiq.

Ajo tha se pasi që këto janë çështje sistematike që prekin të gjitha aspektet e organizimit të shtetit, duke garantuar procese demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut dhe civile, mungesa e progresit adekuat në përmbushjen e kritereve të përcaktuara në kapitujt 23 dhe 24, bllokon progresin në të gjithë kapitujt e tjerë dhe asnjëri prej tyre nuk mund të mbyllet praktikisht derisa të përmbyllen këto dy kapituj kryesorë.

„Shumë çështje, veçanërisht ato që lidhen me sundimin e ligjit, duhet të mundësojnë një sistem me vlera të barabarta, një sistem të harmonizuar ligjor me standardet evropiane, si dhe një qasje të barabartë në të drejtat dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjithë qytetarëve të BE-së“, tha Kordiq.

Sipas saj, nga këndvështrimi i Unionit, hyrja e një vendi anëtar, standardet e të cilit në fushën e sundimit të ligjit janë nën nivelin e përcaktuar, mund të fusë shqetësime sistemike në funksionimin e të gjithë Bashkimit Evropian, duke çuar de facto në mos ekzistencën e barazisë ligjore të të gjithë qytetarëve në territorin e BE-së, që është një ndër parimet demokratike themelore.

„Çështjet kyçe në lidhje me luftimin e korrupsionit endemik, lirinë e medias, kontrollin politik të gjyqësorit dhe të ngjashme kanë mbetur akoma të hapura. Në thelb, përparimi më i madh është bërë në zotërimin e retorikës evropiane, por në arritjen e standardeve të vendosura, në rastin më të mirë, ka ngecje", tha Kordiq.

Kordiq tha se për këtë vijnë mesazhe të qarta nga zyrtarë të BE-së, të cilët tërheqin vërejtjen për rastet e ndarjes së kredive banesore me kushte të favorshme për funksionarët, në kurriz të buxhetit, me ç'gjë vihet në pikëpyetje parimi i sundimit të ligjit, pastaj arrestimi i gazetarëve të In4s, FOS-it, Borba-s dhe shumë çështje të tjera që tregojnë qartë se në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, si dhe sundimit të ligjit, gjërat bënë hapa prapa në vend që të ecnin përpara.

„Ballafaqimi me problemin e krimit të organizuar dhe korrupsionit është ndoshta sfida më e madhe me të cilën do të përballet qeveria e re", tha Kordiq.

Ajo tha se ky kombinim i pushtetit, gjegjësisht i pjesëve të pushtetit me procese të paligjshme problematike që shoqëruan paralelisht tranzicionin malazez, e kthyen çështjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar në një problem endemik.

"Duhet të kihet parasysh edhe fakti se, sipas burimeve të shumta vendase dhe të huaja, grupet e organizuara kriminale në Mal të Zi janë organizata që kanë lidhje të konsiderueshme në botën e krimit jashtë Malit të Zi, që do të thotë se zgjidhja e këtij problemi në vendin tonë është e rëndësishme për stabilitetin e brendshëm të vendeve evropiane. Duhet të pranojmë që kur hyjmë në BE, bëhemi pjesë e së njëjtës - detit evropian, që do të thotë se valët në gjirin tonë godasin brigjet e vendeve të tjera", tha Kordiq.

Ajo vlerësoi se ngërçi në procesin e anëtarësimit është pjesërisht rezultat i politikës së BE-së, ku nuk ka unanimitet për zgjerimin, përkundrazi, rryma të konsiderueshme, të udhëhequra nga vendet më të mëdha të Bashkimit Evropian, shprehin qartë pikëpamjen

se përshpejtimi i procesit të anëtarësimit për vendet e Ballkanit Perëndimor nuk është në këtë moment prioritet i BE-së.

„Përkundër kësaj, përmbushja e standardeve nga kapitujt 23 dhe 24 është një domosdoshmëri që sigurisht do të jetë në rendin e ditës“, ka thënë Kordiq.

Ajo tha se qeveria e re ka mundësinë të tregojë vendosmëri dhe vullnet politik për t'i trajtuar problemet më të mëdha, të njohura tashmë për të gjithë.

„Nëse ajo dëshiron të bëjë përparim në përmbushjen e kritereve nga kapitujt 23 dhe 24, duhet të fillojë të zbërthejë skandalet kryesore që janë në majat më të dukshme të korrupsionit endemik, të tilla si aferat Kllap, Vardari, Mozhuri, Zarfi dhe të ngjashme. Është e domosdoshme të zbatohen rregullat ligjore në mënyrë konsekuente dhe të kryhen të gjitha aktivitetet brenda kornizës ligjore, por është po aq e nevojshme të tregohet vendosmëri dhe një qasje e barabartë për ndjekjen penale të aferave të mëdha dhe të mos përdoren pengesa burokratike si justifikim për mosveprim. Nuk duhet të kemi asnjë dilemë, Bashkimi Evropian është pa dyshim i gatshëm t'i japë mbështetje politike shumicës së re, por sigurisht që nuk ka në plan të mbyllë një sy për këdo në dëm të saj“, përfundoi Kordiq.

Anëtari i Këshillit për Integrimin Evropian nga Partia Demokratike e Socialistëve, **Predrag Sekuliq**, tha se mosdhënia e mendimit pozitiv nga Komisioni Venedikut lidhur me Propozim ligjet mbi ndryshimet në Ligjin mbi prokurori dhe Ligjin mbi prokurori speciale të krimit të organizuar të inicuara nga shumica parlamentare tregon se anëtarët e Komisionit Venedikut dhe zyrtarët e BE-së kanë dalluar tentativen që me këto ligje të zhbëhet institucioni i prokurorisë. Sekuliq shtoi se një pjesë e shumicës parlamentare paralajmëron se do të insistoi në miratimin e këtyre ligjeve pavarësisht qëndrimit të Europes. Sekuliq tha se kjo tregon karakterin antieuropian të Qeverisë dhe të shumicës parlamentare.

„Parlamenti i Malit të Zi, pikërisht për shkak të përmbushjes së detyrimeve nga këto dy kapituj, në vitin 2013 miratoi ndryshimet (I-XVI) të Kushtetutës në lidhje me zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përfshirë zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Predrag Sekuliq

Për fat të keq, përkundër paralajmërimit se po krijohet një sistem që nuk ekziston askund në vendet evropiane, morëm rekomandim nga Komisioni i Venecias për miratimin e amandamenteve“, tha Sekuliq.

I pyetur se cilat do të jenë detyrimet më të vështira që Mali i Zi do të duhet të përmbushë në periudhën e ardhshme, Sekuloviq u përgjigj se të gjithë i kanë detyrimet saktësisht të përcaktuara.

„Qeveria nuk ka shumë kompetenca përpos në pjesën e bashkëpunimit të Drejtorisë së Policisë me Prokurorinë, Kuvendi ka kompetenca vetëm në pjesën e zgjedhjes së gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese si dhe të përfaqësuesve të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, ndërsa gjithçka tjetër është në duart e organizatës prokuroriale dhe gjygjësorit“, tha Sekuliq.

Në pyetjen se si do të ndikojë situata në gjyqësor në përmbushjen e detyrimeve nga kapitujt 23 dhe 24, por edhe në përgjithësi në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Sekuliq tha se fatkeqësisht për shkak se në periudhën e mëparshme disa parti të opozitës bojkotuan punën e Parlamentit kurse të tjerat nuk deshën të diskutojnë këto tema, gjendemi në këtë situatë.

„E gjithë kjo, natyrisht, ndikon në përmbushjen e detyrimeve nga kapitujt 23 dhe 24, por, e përsëris edhe një herë - adresat politike që mbajnë përgjegjësinë më të madhe për një situatë të tillë janë të padiskutueshme“, tha Sekuliq.

Sipas tij, edhe në bazë të Kushtetutës (amandamentet e aprovuara shtatë vjet më parë), bisedimet dhe një marrëveshje midis qeverisë dhe opozitës janë mënyra e vetme për të tejkaluar situatën aktuale në prokurori dhe gjyqësor, duke pasur parasysh që shumica e vendimeve për zgjedhje kërkojnë shumicë prej 2/3, respektivisht 3/5 të votave.

„Por nuk duhet të harrojmë se kjo është vetëm një pjesë e zgjidhjes. Duket se ndërtimi i besimit të qytetarëve në këto institucione është pjesa shumë më e vështirë dhe më kërkuese“, përfundoi Sekuliq.

Zoran Vujiçiq nga Aleanca Qytetare thotë se Mali i Zi është në fazën e negociatave që prej tetë vitesh dhe se megjithëse i ka hapur të gjithë kapitujt, nuk është as afër mbylljes së kapitujve 23 dhe 24.

„Nëse kemi parasysh se Kroacia ka përfunduar negociatat e saj brenda gjashtë viteve, ky konsiderohet një dështim. Megjithëse jo zyrtarisht, procesi i negociatave të anëtarësimit të Malit të Zi është bllokuar në thelb. Gjithashtu, duke miratuar metodologjinë e re si mënyrë të aderimit në BE, Mali i Zi është i papërgatitur për të hyrë në këtë fazë, e cila nënkupton qasjen në fondet e BE-së në përputhje me rezultatet konkrete që do të arrihen“, konsideron Vujiçiç.

Në pyetjen se cilat pjesë janë më të vështira për plotësimin e kritereve, Vujiçiq tregon se Mali i Zi ka kompletuar legjislacionin dhe se ajo që është thelbësore është funksionimi i shtetit ligjor, që do të thotë se askush nuk është mbi ligjin dhe se të gjithë duhet të veprojnë në përputhje me ligjin.

Zoran Vujiçiq

Për fat të keq, Mali i Zi nuk ka rezultate konkrete në këto fusha, gjë që është thelbësore në këtë fazë të negociatave. Institucionet kryesore për sundimin e ligjit janë në gjendjen e ushtruesit të detyrës – një pjesë e Këshillit Gjyqësor nga radhët e avokatëve të shquar, Prokurori i Lartë i Shtetit është ushtrues detyre dhe në 11 prokuroritë shtetërore nuk është zgjedhur ende udhëheqësi. Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor ka marrë vendime që shkelin Kushtetutën dhe ligjin, duke zgjedhur kryetarë të gjykatave në mandatin e tretë, gjë që minon drejtpërdrejt sundimin e ligjit. Nëse i shtojmë kësaj se Gjykata Kushtetuese që prej një viti nuk ka kryetar, duke krijuar funksionin e kryesuesit, vendim të cilin e ka rrëzuar vetë më vonë duke e konsideruar si jokushtetues, kuptojmë se jemi akoma larg asaj që quhet shtet ligjor i qëndrueshëm", ka vlerësuar Vujiçiq.

I pyetur se cilat janë hapat e ardhshëm në këto kapituj, Vujiçiq u përgjigj se së pari duhet të dilet urgjentisht nga gjendja e ushtruesve të detyrës dhe për ta bërë këtë është e nevojshme të nisë dialogu politik, sepse dy të tretat dhe tri të pestat e shumicës në Kuvend janë të nevojshme për zgjedhjet në sistemin gjyqësor.

„Vetëm atëherë mund të fillojmë me reforma serioze që përfshijnë rezultate në fusha të shumta, të tilla si korrupsioni, krimi i organizuar, pastrimi i parave dhe shumë të tjera në fushat 23 dhe 24", ka vlerësuar Vujiçiq.

Sipas tij, nevojiten rezultate konkrete në shumë fusha.

„Hetimi i çështjeve të korrupsionit të lartë, forcimi i pavarësisë dhe përgjegjësisë në gjyqësor, më shumë vendime në fushën e pastrimit të parave. Nevojitet që të fillojë të funksionojë sundimi i ligjit", ka theksuar Vujiçiq.

I pyetur se a beson në mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje politike midis qeverisë dhe opozitës, duke pasur parasysh që gjendja me ushtrues të detyrave është theksuar si një nga problemet kryesore në sistemin gjyqësor, Vujiçiqi tha se është e domosdoshme të gjendet një zgjidhje.

„Kjo nuk është më çështje e politikës, por e të gjithë qytetarëve të Malit të Zi. Prandaj, përfaqësuesit e partive politike janë të detyruar të ulen dhe të arrijnë një zgjidhje të pranueshme përmes dialogut, i cili do të zhbllokojë zgjedhjet në gjyqësor. Është e domosdoshme të animohen profesionistët, njerëzit e fushës dhe organizatat profesionale që të aplikojnë në konkurse, të cilat ishin shumë të politizuara në periudhën e mëparshme dhe njerëzit ishin të dekurajuar të aplikojnë", ka porositur Vujiçiqi.

PO BËHEN GATI TRI DEKADA NGA KRIMI I LUFTËS „KLLAPUH“ NË MRATINJE TË PLLUZHINËS

Drejtësia në pritje

Pesë persona së bashku janë dënuar me më tepër se 80 vite burg, por 25 vite më vonë askush as që ka përfunduar në burg.

Autorët:

Nikola Savelliq

Drejtësia është e ngadaltë, kurse për familjen Kllapuh nga Foça, të cilët u vranë brutalisht afro tri dekada më parë, duket e paarritshme. Në korrik të këtij viti do të mbushen 29 vite qëkur katër pjesëtarë të njësisë “Dragan Nikoliq” të Ushtrisë së Republikës Srpska - Janko Janjiq, Radomir Kovaç, Zoran Simoviq dhe Zoran Vukoviq, vranë brutalisht familjen Kllapuh. Megjithatë, askush prej tyre nuk u përgjigj penalisht për këtë krim, pavarësisht se 25 vite më parë ishin dënuar me nga 20 vjet burg. Vetëm Vidoje Gollubiq, një ndihmës nga Mali i Zi, vuajti dënimin prej tetë muajsh burg për moskallëzim të krimit.

Hasan Kllapuh, ekonomist me profesion, dikur edhe nënkryetar i Komunës së Foçës, gruaja e tij Ferida dhe vajza Sena, inxhiniere e sapodiplomuar e inxhinierisë, synuan të largoheshin nga

vorbulli i luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 1992. Ata kërkuan ndihmë nga fqinji i tyre i vjetër Janko Janjiq, i cili u premtoi se për një shumë të caktuar parash do t'i transferonte ata në zonë të sigurt në Mal të Zi, në atë kohë i vetmi territor që nuk ishte prekur nga lufta.

Hetimi i kryer tregoi se ushtarët e njësisë e kaluan familjen përmes doganës, më 6 korrik 1992, dhe sipas hetimit, nxorën Hasanin, Feriden dhe Senen nga automjeti pranë digës në Mratinje dhe u ndalën në urën „Obrada Cicmilla". Së pari e qëlluan Hasanin në pjesën e pasme të kokës, pastaj i qëlluan Feridën dhe Senën dhe i shtynë poshtë shkëmbit. Autopsia tregoi se Ferida dhe Sena vdiqën disa orë pasi u qëlluan.

Policia malazeze, në bashkëpunim me doganierët, mësuan emrat e vrasësve që kaluan kufirin së bashku me familjen Kllapuh. Një muaj më vonë u arrestua Vidoje Gollubiq, kur erdhi në Pluzhine për të vizituar gruan dhe fëmijën e tij. Pas arrestimit dhe dëshmisë së tij nisi procesi gjyqësor. Këshilli Penal i Gjykatës së Lartë në Podgoricë, i kryesuar nga gjykatësi Miliq Megjedoviq, i dënoi me 20 vjet burg në mungesë Zoran Vukoviqin, Janko Janjiqin, Radomir Kovaçin dhe Zoran Simoviqin. Vidoje Gollubiq u dënua me tetë muaj burg „për moskallëzim të krimit".

Megjithëse aktakuza i ngarkonte të pestit për kryerjen e krimit të luftës kundër civilëve, gjykata i dënoi ata për veprën penale – vrasje për shkak të lakmisë.

Tre vite më vonë, pas ankesës së Prokurorisë, Këshilli Penal, i kryesuar nga Stevan Damjanoviqi, më 1996 e ndryshoi vendimin e shkallës së parë, duke argumentuar se „për përkufizimin e krimit të luftës nuk ka rëndësi nëse ai është kryer në territorin e prekur nga lufta, por që të ketë lidhje me luftën". Kështu Mali i Zi mori vendimin e parë gjyqësor për krime lufte. Në atë kohë, ky ishte edhe verdikti i parë i këtij lloji në ish-RSFJ.

Ky fakt ishte shumë i rëndësishëm për Malin e Zi, konsideron drejtoresha ekzekutive e OJQ "Aksioni për të Drejtat e Njeriut" (HRA), Tea Gorjanc Preleviq, e cila ka vite që angazhohet në zbardhjen e krimeve të luftës.

"Po, me të vërtetë, bëhet fjalë për aktgjykimin e pare, madje për një aktgjykim të mirë në aspektin e zbatimit të ligjit në përputhje me të drejtën ndërkombëtare humanitare, në të cilën Gjykata Supreme konfirmoi se bëhej fjalë për krim lufte për shkak të lidhjes së tij me konfliktin e armatosur në Bosnje dhe Hercegovinë. Sigurisht se është e papranueshme që vendimi është zbatuar vetëm ndaj një ndihmësi në vrasjen e familjes Kllapuh dhe asnjë prej ekzekutorëve tjerë të drejtpërdrejtë", thotë Gorjanc Preleviq.

Për shkak të krimit të kryer, Vidoje Golluboviq ishte i vetmi i pranishëm në gjyq, ndërsa të tjerët u gjykuan në mungesë, sepse ishin në arrati. Një nga autorët e krimit të rëndë, Zoran Vukoviq, u

arrestua në janar të vitit 2016 në Serbi. Megjithatë, ekstradimi i tij në Malin e Zi nuk ka ndodhur ende, pavarësisht kërkesës nga autoritetet malazeze. Procedura e ekstradimit zgjat tash katër vite dhe nuk ka përfunduar ende, megjithëse, siç shpjegon vetë Gorjanc Preleviq, procedurat e tilla përfundojnë relativisht shpejt.

"Ajo që më tepër ngre dyshime është fakti që askush nuk na shpjegon, as në Mal të Zi dhe as në Serbi, pse zgjat kaq shumë kjo procedurë. Për shembull, gjenerali i Ushtrisë së Republika Srpska Novak Gjukiq, i cili u dënua me 20 vjet burg në Bosnjë dhe Hercegovinë për shkak të urdhrit për bombardimin e Tuzllës, ku 71 civilë u vranë dhe 140 u plagosën. Gjukiq më pas u largua në Serbi, ku gjeti strehim, ndërsa Komisioni Evropian, në raportin e tij të fundit për Serbinë, kritikon veçanërisht faktin që Serbia nuk e ekzekutoi vendimin kundër tij, edhe pse marrëveshja me Bosnjë dhe Hercegovinën e mundëson këtë. E njëjta gjë ka mundësi të ndodhë edhe me rastin e Vukoviqit", thekson Gorjanc Preleviq.

Ne nuk kemi fituar përgjigje në këto pyetje nga Ministria e Drejtësisë e Malit të Zi dhe asaj të Serbisë fqinje. Përgjigjja vjen vetëm nga Drejtoria e Policisë, në pyetjen nëse për këta persona është lëshuar urdhërarresti i Interpolit dhe cili është aktualisht statusi i tyre.

Kështu, nga Drejtoria e Policisë e kanë konfirmuar informacionin se që pesë vjet më parë, policia serbe e ka arrestuar Zoran Vukoviqin dhe se gjykatësi i Gjykatës Speciale në Beograd caktoi masën e paraburgimit ekstradues.

"Ne jemi informuar nga Ministria e Drejtësisë e Malit të Zi se ata e kanë dërguar kërkesën për ekstradimin e personit në fjalë, por nuk kanë ndonjë reagim nga Republika e Serbisë. Departamenti për Bashkëpunim Policor Operacional Ndërkombëtar INTERPOL-EUROPOL-SIRENE nuk arriti të marrë kurrfarë informacioni kthyes nga autoritetet kompetente të Republikës së Serbisë dhe NCB Interpol Beograd, në lidhje me statusin e këtij personi edhe përkundër shumë urgjencave dhe deri më sot personi nuk është ekstraduar në Mal të Zi", deklarojnë nga Drejtoria e Policisë.

Në janar të vitit 2017, HRA i dërgoi një letër ministrit të atëhershëm të Drejtësisë dhe Zëvendëskryeministrit Zoran Pazhin, duke e informuar se njëri nga autorët e dënuar, Radomir Kovaç, gjendej në liri në Bosnjë dhe Hercegovinë.

HRA thotë se ata nuk e dinë nëse dhe çfarë është bërë për të gjetur Zoran Simoviqin dhe që të zbatohet aktgjykimi në lidhje me të.

"Në tërësi, duket se organet shtetërore malazeze nuk e marrin seriozisht nevojën për të ekzekutuar vendimin gjyqësor për një krim kaq të rëndë, i cili është shumë shqetësues dhe pasqyron

qëndrimin e pafavorshëm ndaj kërkesave të drejtësisë së tranzicionit, që është një nga kushtet parësore për Komisionin Evropian në procesin e anëtarësimit në BE", konstatojnë nga HRA.

Bazuar në urdhërarrestin e Interpolit, policia malazeze ka vetëm informacion se Zoran Simoviq dhe Radomir Kovaç, të cilët janë shtetas të Bosnjë dhe Hercegovinës, e kanë të paraqitur vendbanimin në territorin e këtij vendi.

„Duke qenë se Marrëveshja e Ekstradimit midis Malit të Zi dhe Bosnjë dhe Hercegovinës përcakton që ekstradimi i shtetasve të vet për vepra penale lejohet vetëm për vepra penale të kryera pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, këta persona nuk mund të privoheshin nga liria në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe t'i dorëzoheshin Malit të Zi, bazuar në dispozitat e kësaj marrëveshjeje", theksojnë në Drejtorinë e Policisë.

„Kam pritur nga ministri Pazhin që lëndën me provat dhe aktgjykimin në fuqi t'iu dorëzojë organeve të Bosnjë dhe Hercegovinës në mënyrë që Kovaç të gjykohet përsëri atje, sepse marrëveshja e ekstradimit midis Malit të Zi dhe Bosnjë e Hercegovinës, e cila është nënshkruar dhe ratifikuar më vonë, nuk lejon që Mali i Zi të kërkojë ekstradimin e tij. Asnjëherë nuk kam marrë përgjigje në atë shkresë dhe nuk e di se çfarë ka bërë ministri me atë rast, d.m.th. a ka bërë ndonjë gjë. Tani do t'i drejtohemi me shkresë ministrit të ri Vlladimir Leposaviq dhe do të përpiqemi ta mësojmë të vërtetën", thotë Gorjanc Preleviq.

Edhe ne i kemi drejtuar pyetjet Ministrisë së Drejtësisë lidhur me atë se çfarë po bën shteti i Malit të Zi për t'i sjellë para drejtësisë autorët e këtij krimi, por nuk kemi marrë përgjigje.

Përndryshe, Radomir Kovaç, Zoran Vukoviq dhe Janko Janjiq janë akuzuar nga Tribunali i Hagës për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në sulmin ushtarak në Foça dhe disa fshatra përreth, arrestimin dhe vrasjen e civilëve myslimanë, torturim dhe përdhunimin e grave. Në fund të vitit 1999, pjesëtarët e forcave speciale të njësive të NATO-s arrestuan Kovaçin dhe Vukoviqin. Dhjetë muaj më vonë, Janko Janjiqi, duke ikur nga policia, vrau veten duke aktivizuar një granatë dore. Gjykata e Hagës e dënoi Radomir Kovaçin me 20 vjet burg dhe ai ende po vuan dënimin në Norvegji. Zoran Vukoviqi u dënua me 12 vjet burg. Ai gjithashtu e vuajti dënimin në Norvegji dhe u lirua pasi vuajti dy të tretat e dënimit. Pas kthimit në Bosnjë dhe Hercegovinë, humbën të gjitha gjurmët e tij. Zoran Simoviqi mbeti i paarritshëm edhe për shërbimet e inteligjencës perëndimore dhe sot nuk dihet vendndodhja ku ai jeton.

Gorjanc Preleviq nuk ka dyshim se është e domosdoshme për çdo shtet në territoret post-jugosllave të zbatojë drejtësinë penale dhe të sigurojë dëmshpërblime për viktimat e të gjitha krimeve të luftës.

"Këto janë kërkesat themelore të drejtësisë tranzicionale. Shtetet dhe shoqëritë e tyre duhet të përballen me krimet e kryera në emër të tyre dhe të përcaktojnë përgjegjësinë. Mbetet një trashëgimi e vështirë që prodhon arsye për armiqësi të reja dhe viktima të reja, ndërsa nga ana tjetër tregon se shteti ende nuk ka institucione të afta për të realizuar drejtësinë. Mali i Zi nuk ka aq shumë krime për të ndjekur penalisht sa vendet e tjera në rajon dhe ai mund të kishte ndjekur penalisht gjithçka në një mënyrë adekuate deri më tani, nëse do të kishte pasur vullnet për këtë", përfundon Gorjanc Preleviq.

Hasan, Ferida dhe Sena Kllapuh u varrosën në një varrezë të përkohshme te Trebjesa, afër një pylli me pisha, ku varrosen ata që nuk kanë askënd nga familja. Varrimi u krye nga Komuna e Nikshiqit. Djali i Hasanit, Feridi, i vetmi anëtar i mbijetuar i familjes, i cili nuk ishte me prindërit dhe motrën e tij atë ditë fatale, ka ardhur disa herë në Mal të Zi, me qëllimin që trupat e familjes së tij t'i zhvendosë në Bosnjë dhe Hercegovinë. Sipas informacioneve në dispozicion, në vitin 2016, Feridi arriti t'i riatdhesojë eshtrat e të dashurve të tij dhe t'i varroste në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Megjithatë, Feridi dhe familja Kllapuh, që prej tri dekadash, janë akoma në pritje të drejtësisë që nuk duket se do të mbërrijë.



MOSPAGIMI I ALIMENTACIONIT, PROBLEM I NËNAVE – PRINDËRVE VETUSHQYES

Institucionet e transferojnë përgjegjësinë kur kërkohen shifrat

Ministria e Punës dhe e Përkujdesjes Sociale nuk ka të dhëna për numrin e nënave vetushqyese në Mal të Zi. Në këtë dikaster të Qeverisë nuk kanë të dhëna për numrin e nënave vetushqyese të cilat përfitojnë alimentacionin.

Autorët:

Sandra Miliqeviq

Lidija Roganoviq

Ka bërë ceremoni martesore, ka luajtur futboll, tenis, ka bërë jetë luksoze, kurse nuk e ka paguar alimentacionin për mua dhe fëmijët, por unë nuk mund ta vërtetoj, sepse asgjë nuk ishte e regjistruar në emrin e tij... e përshkruan problemin e vet nëna vetushqyese, e cila dëshironte të qëndronte anonime, sepse nuk dëshiron që t'i dalë emri në media, apo atë t'ia lexojnë fëmijët.

Edhe pse ligjet malazeze përcaktojnë se prindërit duhet të paguajnë alimentacionin deri në moshën 18-vjeçare të fëmijës, e në rast se fëmija në moshë madhore është duke vijuar shkollimin e rregullt, deri në moshën 26-vjeçare, në praktikë nuk ndodh kështu.

Numri i prindërve vetushqyes dhe i atyre që përfitojnë alimentacionin, në institucionin kulmor – Ministrinë e Punës dhe Përkujdesjes Sociale – nuk është i njohur. Në thirrjet e shumta të gazetarëve, ata u janë përgjigjur përmes telefonit se – „Ligji për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve nuk e njeh termin 'nëna vetushqyese'".

Mirëpo avokatja e OJQ „Shtëpia e Sigurt", Tijana Vuksanoviq, shpjegon definicionin e prindërit vetushqyes. „Neni 19, paragrafi 1, pika 10a e Ligjit për Mbrojtjen Sociale dhe të Fëmijëve nënkupton të dy prindërit individualisht, pra edhe nënat vetushqyese".

Ish-burrat shpesh e fshehin pronën

Nëna vetushqyese apelon te gjykatat dhe prokuroria malazeze që çështjet gjyqësore që lidhen me alimentacionin të kenë prioritet. Ajo shpjegon se ish-burri, konform dispozitave ligjore, pas divorcit e ka paguar alimentacionin.

„Vetëm disa muaj. Pastaj e ka ndërprerë, kështu që kam vendosur t'i dorëzoj gjyqit propozimin për ekzekutimin e vendimit", thotë ajo.

Ajo sqaron se procedura nënkupton që përmbaruesi publik t'ia dorëzojë të dhënat bankës, e cila e bllokon llogarinë bankare derisa të mos i shlyejë detyrimet e pagesës.

„Në rastin tim, kjo ishte e vështirë, sepse ai nuk i ka paguar të hollat nëpërmjet llogarisë bankare. Hapi i ardhshëm ishte propozimi për hipotekimin e pronës, mirëpo as kjo nuk ishte efikase, sepse çdo gjë ishte e regjistruar në emër të babait tij – automjeti, shtëpia dhe banesat", theksoi ajo.

Nga mekanizmat juridike i kishte mbetur të dorëzojë padi penale për mospagimin e alimentacionit.

„Padinë e kam parashtruar te Prokuroria Themelore e Shtetit dhe pas kësaj jemi ftuar që të deklarohemi", thotë ajo.

Në prokurori treguan ndjesi për problemin e saj, por procesi zgjati shumë.

„As pas afatit gjashtëmujor ai nuk e ka paguar borxhin, as shumën e rregullt. Unë është dashur të jem këmbëngulëse, sepse procesi vazhdoi pas katër muajsh. Ai është munduar ta kompensojë atë shumë duke ofruar llogari për blerjen e atleteve dhe nevojave të

rregullta të fëmijëve, gjë që nuk është e lejuar me ligj“, ka thënë ajo.

Në seancën kryesore është diskutuar për dërgimin e bashkëshortit në burg, gjë që ajo e ka refuzuar. Ka pasuar dënimi me kusht që në afat prej një viti të paguajë alimentacionin e prapambetur, sepse përndryshe do ta priste dënimi me burg. Ish-bashkëshorti është ankuar për gjendjen e keqe materiale, derisa gjendja reale, siç thekson kjo nënë vetushqyese, ishte ndryshe.

„Ka bërë jetë luksi, por asgjë nuk figuronte në emër të tij“, ka theksuar ajo.

Rastësisht, gjendja e tij materiale ndryshoi falë shitjes së pronës familjare në shumë milionëshe.

„Blerësi i pronës është dashur t'i paguajë të hollat në llogarinë bankare të ish-bashkëshortit tim, por llogaria ka qenë e bllokuar. Për ta zhbllokuar është dashur të paguajë shumën e prapambetur të alimentacionit. Ka paguar vetëm një pjesë“, ka shtuar ajo.

Pas kësaj, një kohë të shkurtër e ka paguar alimentacionin, pastaj përsëri e ka ndërprerë. Përsëri ka parashtruar propozimin për ekzekutim.

Beteja e kësaj gruaje në gjykatë zgjat që katër vite.

MT: Shuma minimale për ekzistencë

Shuma më e ulët e alimentacionit është 67 euro për fëmijë, nëse prindi nuk është i punësuar dhe nuk ka mjete për jetesë.

Dejana Ponosh nga OJQ „Shoqata Prindërit“ thotë se „me përfundimin e martesës mbaron roli ynë martesor, por jo edhe prindëror“.

„Një nga problemet e dalluara është alimentacioni i ulët dhe mospagimi i tij. Nuk janë gjetur mekanizmat për themelimin e fondit të alimentacionit, nuk ekziston vullneti i shprehur nga përgjegjësit për të zgjidhur diçka“, ka theksuar Ponosh.

Avokatja e Qendrës për të Drejtat e Gruas, Tijana Zhivkoviq, thotë se ka prindër që qëllimisht e shmangin pagesën, por edhe të tillë që nuk mund ta kryejnë për shkaqe objektive. Shkak për këtë është sëmundja dhe të ngjashme. Ajo e sheh zgjidhjen në themelimin e fondit të alimentacionit dhe ashpërsimin e politikave ndëshkimore.

„Ekzistenca e fondit të alimentacionit pa dyshim që do të siguronte realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të fëmijëve, kurse shteti nga ana tjetër, duhet të parashiko-

jë mekanizmat e pagesës nga ofruesi i mbështetjes, në emër të të cilit janë bërë pagesat e alimentacionit nga fondi“, ka shpjeguar avokatja.

Mospagimi i alimentacionit është një prej formave të rënda të dhunës ndaj femrave dhe fëmijëve, sipas Konventës së Stambollit, nënshkruese e së cilës është Mali i Zi. Avokatja Zhivkoviq tregon se çfarë strategjie përdorin ofruesit e mbështetjes për të shmangur pagesën.

„Puna në të zezë, regjistrimi i të drejtave pronësore mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme te personat e tjerë, hapja e firmave në emër të personave të tjerë dhe të ngjashme, janë vetëm disa prej mënyrave që ofruesit e mbështetjes financiare përpiqen t’i shmangen detyrimit të pagesës së alimentacionit“, thekson Zhivkoviq.

E drejta e publikut për të ditur dhe institucionet përgjegjëse

Ministria e Punës dhe e Përkujdesjes Sociale nuk ka të dhëna për numrin e nënave vetushqyese në Mal të Zi. Në këtë institucion janë shprehur se nuk kanë të dhëna për numrin e prindërve vetushqyes dhe kanë theksuar se Ligji për mbrojtjen sociale dhe të fëmijëve nuk e njeh termin „nëna vetushqyese“.

Në këtë dikaster të Qeverisë nuk kanë të dhëna as për numrin e nënave vetushqyese të cilat përfitojnë alimentacion. Pas telefonatave dhe e-maileve të shumta, janë përgjigjur se për këtë është kompetent gjyqi. Sidoqoftë, kërkesa për përgjigje në këtë pyetje po bëhet gjithnjë e më e pasigurt.

Gjykata Themelore në Podgoricë nuk i ka të dhënat e kërkuara, prandaj na kanë drejtuar te Gjykata Supreme. Nga Gjykata Supreme u përgjigjën se nuk i kanë këto të dhëna dhe shtuan:

„Sugjerojmë që lidhur me këtë t’i drejtoheni ndonjë gjykate themelore, të cilat në këto procedura janë gjykata të shkallës së parë, si dhe Gjykatës së Lartë në Podgoricë ose Bijello Polje, si gjykata të shkallës së dytë“.

Pas përgjigjes nga Gjykata Supreme, Gjykata Themelore i ka përcjellur të dhënat lidhur me aktvendimet për shkak të mospagimit të alimentacionit.

„Deri në mes të tetorit 2020 janë shqiptuar pesë dënime me kusht për veprën penale të mospagimit të mbajtjes nga neni 221 i Kodit Penal të Malit të Zi. Në vitin 2019, ky numër ishte 49, prej të cilëve gjashtë kanë të bëjnë me dënime me burg, 35 dënime me kusht dhe gjashtë dënime me punë në interes publik“, këto janë të dhënat që kemi arritur t'i fitojmë.

Barrë e madhe për gra

Psikologia Jovana Strugar vlerëson se nënat vetushqyese shpesh bartin barrë të madhe të shqetësimit, duke paralajmëruar se gratë kanë nevojë për përkrahje shtesë.

Strugar shpjegon se prindërimi vetushqyes vjen jo vetëm me ndërprerjen e marrëdhënies martesore, por edhe me vdekjen, humbjen dhe largimin e njërit prej partnerëve. Ajo shton se është e nevojshme të zhvillohen strategjitë e ndihmës në nivel të individit dhe shoqërisë.

„Atë që shoqëria mund të bëjë për këtë çështje është të ndërtojë kapacitete institucionale të fuqishme për të ndihmuar prindërit vetushqyees (ndihma materiale, kopshtet etj.), të promovojë fuqizimin femëror, pavarësinë ekonomike dhe të krijojë mundësitë ku femrat mund të realizohen në role të ndryshme. Rrjeti familjar dhe miqësor po ashtu mund të jetë një ndihmë e madhe, duke ofruar kapacitetet e tyre", ka thënë psikologia.

Nga ana tjetër, Qendra për Punë Sociale në bashkëpunim me Entin për Punësim ka një plan veprimi lidhur me gjetjen e punës për prindërit vetushqyes – përfitues të mbështetjes materiale. Ligji për mbrojtje sociale dhe të fëmijëve në nenin 15 përcakton: „Për shfrytëzuesit, të drejtat dhe ofruesit e shërbimeve mbahet evidenca, në përputhje me këtë ligj."

Kemi kontaktuar Qendrën për Punë Sociale. Pas një muaj e gjysmë pritjeje të përgjigjes nëpërmjet e-maileve dhe shumë thirrjeve telefonike, fituam përgjigje për numrin e nënave vetushqyese të punësuara përmes bashkëpunimit të Qendrës dhe Entit. Kjo ishte përgjigjja e tyre:

„Qendra nuk ka informata për momentin se sa shfrytëzues janë punësuar."

Në anën tjetër, të dhënat e vjetra të Monstat-it (2011) tregojnë se në Mal të Zi ka rreth 25.000 familje që përbëhen nga nëna me një fëmijë. Ndërsa familje ku babai jeton vetëm me një fëmijë janë mbi pesë mijë.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2020 kanë ndodhur 257 divorce, derisa janë lidhur 663 martesa. Të dhënat e Monstatit tregojnë se numri i divorceve në vitin 2019 ishte 841, kurse më 2018 ky numër ishte 849.

PARREGULLSITË GJATË NDËRTIMIT TË MINI-HIDROCENTRALEVE NË LUMENJTË CRNJA, LJUBASHTICA DHE CRNI POTOK

Tubat janë rritur, llojet e mbrojtura të harruara

Sipas dokumentacionit projektues të Studimit të miratuar, në bazë të të cilit është lëshuar leja më 9. 12. 2011 për tubacionin nga ujëgrumbulluesi deri tek objekti i makinerisë për mHe "Crni potok", ka qenë i parashikuar instalimi i tubave me diametër 56cm, kurse në vetë kantierin e tubacionit janë vendosur tuba me diametër 81cm. Ato janë vendosur përgjatë rrjedhës së ujit. Megjithatë, gjatë inspektimit, me ç'rast vendasit pretendojnë se inspektori vizitoi vetëm ujëgrumbulluesin, është konstatuar se ishte instaluar tubi me diametër 50cm i cili shërben për derdhjen e përkohshme të ujit nga ujëgrumbulluesi në mënyrë që të kryhen punimet pa pengesa.

Autor:

Vuk Vujisiq

Tash tre muaj banorët e Kraljskih Bara dhe aktivistët ekologjikë mblidhen çdo javë duke protestuar kundër ndërtimit të mini-hidrocentraleve (mHE) në lumenjtë Crnja, Ljubashtica dhe Crni Potok.

Në tabelën identifikuese të punimeve, të vendosur tri kilometra larg vendit të ndërtimit të hidrocentralit "Crni Potok", shkruan se ndërtimi ka filluar më 16 dhjetor 2011, kurse afati i përfundimit të punimeve është më 30 nëntor 2016. Hidrocentrali "Crni Potok" nuk është ndërtuar as katër vite pas. Punimet janë intensifikuar vetëm rreth datës 20 korrik 2020, por me kërkesë të banorëve vendas, vetëm gjashtë ditë pas rifillimit, më 26 korrik, janë ndërprerë sërish dhe nuk kanë vazhduar më. Para zgjedhjes së Qeverisë së re ka pas tentativë të kompanisë ndërtuese të vazhdoj punimet, mirëpo banorët vendas nuk e lejuan këtë përkundër presioneve të mëdha që vinin nga NKT (Trupi Kordinues Kombëtar) dhe organet e rendit. Banorët vendas rrëfejnë çdo javë për parregullsi dhe të panjohura që e shoqërojnë këtë rast, për çka e kanë informuar Qeverinë e re. Në vazhdim do të merremi me ato më të rëndësishmet.

Fotografi e tabelës së punimeve. Burimi: PCNEN Foto: Vuk Vujisiq

Çestogaz

Ujëgrumbulluesi (diga) i filluar i mHe "Crni potok", sipas projektit njëdekadësh të vjetër nga Studimi për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor, është dashur të ndërtohet në kuotën 1 206 metra lartësi mbidetare, ku do të akumulonte ujin nga Crni Potok i cili, sipas banorëve vendas, derdhet në Çestogaz, i cili më tej derdhet në Ljubashticë (degë e Crnjes). Kjo do të thotë se ujëmbledhësi i filluar nuk do ta grumbullonte ujin vetëm nga Crni Potok, siç shkruan në projektin bashkëngjitur Studimit, por edhe nga përroi i fuqishëm Çestogaz që derdhet në Ljubashticë, degë e të cilit është Crni Potok. Me këtë, theksojnë banorët vendas, "vidhet Çestogazi, i cili nuk përmendet askund në letër, me përjashtim në përshkrimin si degë e Ljubashticës".

"Crni Potok gjendet në dokumtetet projektuese, kurse Çestogazi nuk përmendet në asnjë vend. Të gjithë e dimë se Crni Potok derdhet në Çestogaz dhe jo e kundërta, kështu që mund të themi se po vidhet shteti", thotë vendasi **Vlladimir Novoviq**.

Përmasat e tubave

Sipas dokumentacionit projektues të Studimit të miratuar, në bazë të të cilit më 9 dhjetor 2011 është dhënë leja për vendosjen e tubacionit nga ujëgrumbulluesi deri tek objekti i makinerive për mHe "Crni Potok", ka qenë i parashikuar instalimi i tubave me diametër 558.8 (56cm). Megjithatë, në vetë kantierin e tubacionit janë vendosur tuba me diametër 81cm, ndërsa tubat e njëjtë janë vendosur edhe përgjatë rrjedhës së ujit.

Gjatë inspektimit, me ç'rast vendasit pretendojnë se inspektori vizitoi vetëm ujëgrumbulluesin, është konstatuar se ishte instaluar tubi me diametër 50cm, i cili shërben për derdhjen e përkohshme të ujit nga ujëgrumbulluesi në mënyrë që të kryhen punimet pa pengesa.

"Kantierin e ka vizituar fillimisht inspektori për ujëra e pastaj inspeksioni për ndërtim. Erdhën pa paralajmërim, kurse ne ishim këtu. Nuk është çudi që në procesverbal ka shënuar vetëm tubin 50 cm kur inspektori vizitoi vetëm ujëgrumbulluesin", **thotë Novoviq**. Ai tërheq vërejtjen se inspeksioni nuk ua ka dorëzuar akoma përgjigjet dhe vendimet.

Novoviq shton se kjo paraqet edhe një formë të "vjedhjes", sepse vendosen tuba me diametër më të madh, për ç'gjë jemi bindur edhe vetë. Nga vizita në terren kemi vërejtur se punimet kanë filluar me tuba me diametër 81cm.

Tubat ujore në vendpunimin Bara Kraljska

Leja e skaduar

Në vendimin e lëshuar më 9 dhjetor 2011 shkruan se investitorit i pushon e drejta e ndërtimit sipas lejes së dhënë, në qoftë se ndërtimi i objektit nuk fillon brenda dy viteve nga data e lëshimit të lejes – neni 97 i Ligjit mbi planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e objekteve. Banorët vendas thonë se investitori i ka filluar punimet vetëm në vitin 2017 dhe se leja duhej të revokohej.

"Kjo leje duhet të ishte revokuar, sepse ne e dimë që ai i filloi disa punime vetëm në vitin 2017 te objekti i makinerive ku gjendet tabela dhe ato pastaj u ndërprenë. Megjithatë, tani na shfaqet një manipulim sikur ai i ka filluar punimet në vitin 2012, gjë që nuk është e vërtetë dhe të gjithë ne e dimë këtë. Mirëpo, shumica e raporteve të inspektimit janë falsifikime dhe dikush duhet të jetë përgjegjës për këtë", thotë **Millovan Llaboviq**, kryetar i BL Bare Kraljske.

Një nga kërkesat e vendasve është revokimi i lejes së ndërtimit dhe zgjidhja (prishja) e kontratës së koncesionit. Me ndihmën e OJQ-së Qendra për Edukim Qytetar, banorët vendas i kanë dërguar kërkesë Qeverisë, mirëpo në Ministrinë për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Turizëm (MZhQT) kanë nxjerrë vendimin se kërkesa është e pabazuar dhe se lejet janë lëshuar konform ligjit. Pas këtij vendimi, Qendra për Edukim Qytetar në emër të vendasve ka dorëzuar padi në Gjykatën Administrative.

"Konsiderojmë se lejet e ndërtimit që janë lëshuar janë plot paligjshmëri. I kemi parashtruar Qeverisë propozimin për anulimin e lejeve, mirëpo Ministria për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Turizëm ka marrë vendim për refuzimin e propozimit tonë. Në arsyetim MZhQT nuk ka dhënë ndonjë arsye dhe argument të vlefshëm për të cilën do të kundërshtohej kërkesa jonë, prandaj për këtë arsye kemi parashtruar aktpadi në Gjykatën Administrative. Proceset janë plot me parregullsi, prandaj për këtë arsye i bëjmë thirrje Qeverisë që të pranojë kërkesën e banorëve vendas dhe të anulojë kontratat", thotë **Snezhana Kallugjeroviq**, këshilltare e lartë ligjore në Qendrën për Edukim Qytetar.

Kantieri nuk e ka respektuar Studimin

Gjatë vizitës në terren gjatë muajve të parë qarkullimi i ujit në ujëmbledhës është bërë ekskluzivisht përmes një tubi të përkohshëm me diametër 50cm, i cili ujin në vazhdim e shkarkonte nga një lartësi prej më shumë se dy metra. Banorët vendas pohojnë se kjo ka rrezikuar lëvizjen e peshqve, se peshqit duhet të lejoheshin të lëviznin lirshëm dhe se kjo mënyrë e ndërtimit, sipas Studimit, është e ndaluar.

Por, pas shirave të mëdha kanali i përkohshëm i cili tërë ujin e orientonte në tub u shemb dhe Çestogazi tani rrjedh i papenguar përmes ujëmbledhësit. Para disa ditësh, vendasit kanë filmuar troftën e përroit në ujëmbledhës. Lidhur me këtë kemi pyetur kryetarin e Federatës së Peshkatarëve të Malit të Zi, **Omar Bashiqin**, se si ndikojnë mini-hidrocentralet në fondin e peshkut.

"Në jetën dhe lëvizjen e peshqve dhe organizmave të tjerë ujorë përmes rrjedhës së ujit, ndikimin më të madh, qoftë nëse flasim për ndikim pozitiv apo negativ, e ka sasia përgjithshme e ujit, d.m.th. e nivelit të ujit në shtratin e lumit. Mini-HEC-et në ujëmbledhësit e tyre, që janë ndërtuar në shtretërit e lumenjve, e ridrejtojnë një sasi të madhe të ujit nga shtratet e lumenjve, e cila më tej, përmes tubacioneve, qarkullon deri në impiantet e makinerive", shpjegon Bashiq.

Sipas tij, në periudhën e nivelit minimal të ujit, të rrallë janë koncesionarët, d.m.th. pronarët të cilët e respektojnë rregulloret ligjore në lidhje me sigurimin e nivelit të ujit në regjimin e minimumit biologjik.

"Pronarët e mHEC-eve kujdesen për çdo pikë uji për të prodhuar disa kW energji elektrike më tepër. Në disa lumenj mund të vërehen edhe shtretër lumenjsh të tharë plotësisht, në të cilët peshqit dhe organizmat ujorë sigurisht që nuk mund të mbijetojnë", thekson ai.

Në thelb, të gjitha mHEC-et kanë ndikim negativ në fondin e peshkut dhe organizmat e tjerë ujorë, veçanërisht në pjesët e rrjedhave që janë "urëzuar" me tubacione nga ujëmbledhësi deri në kthimin prapë të ujit në shtratin e lumit, pas objekteve të makinerive. Jo rrallë i njëjti ujë çohet më poshtë përmes ujëmbledhësve dhe tubacioneve të reja deri te objektet tjera të makinerive, kështu që ekosistemi është i rrezikuar gjatë gjithë rrjedhës së tij. Në pjesë të tilla të lumit, bota e kafshëve sigurisht që është e rrezikuar ose është shuar. Në pyetjen se si rrugët e peshkut e zgjidhin problemin e lëvizjes së peshkut, Bashiq përgjigjet:

"Zgjidhjet teknike të shtigjeve të peshkut janë kryesisht të dobishme, por do të ishin të përdorshme vetëm në kuptimin që shtigjeve të peshkut dhe teposhtë rrjedhës së mëtejshme të lumenjve të kishte sasi të mjaftueshme të ujit në shtrat dhe vetë rrugën e peshkut, në mënyrë që peshqit të lëvizin lirshëm. Por, shtigjet e ndërtuara të peshkut pa dyshim që përdoren nga pronarët vetëm për kullimin e ujit të tepërt gjatë kohës së nivelit të lartë të ujit, kurse në kohën e nivelit të mesëm ose minimal, ato nuk i shërbejnë qëllimit, sepse gjatë ndërtimit pronarët janë kujdesur që uji të drejtohet sa më sshumë që të jetë e mundur në kanalet kulluese dhe tubacionet sesa në shtigjet e peshkut. Shtigjet e ndërtuara të peshkut paraqesin vetëm maskë dhe makiazh për përmbushjen e detyrimeve ligjore nga pronarët e mini-hidrocentraleve, sepse nëpër to nuk kalon as uji e lëre më peshku me ujë", thekson Bashiq.

Ai tërheq vërejtjen se shtigjet e peshqve janë shpesh të papërdorshme.

"Gjithashtu, shumica e shtigjeve të peshqve kanë shpate të pjerrëta, kështu që është i vështirë qarkullimi për peshqit e vegjël, veçanërisht për organizmat e tjerë ujorë, por me kusht që nëpër shtigje të rrjedhë ujë, si dhe që asnjë shteg i peshkut nuk është ndërtuar që peshku dhe organizmat e tjerë ujorë t'i përkujtojë në shtratin natyror dhe mjedisin në të cilin do të lëviznin lirshëm", përfundon Bashiq.

Çestogazi dhe Ljubashtica të bashkuara

Studimi me plot mangësi

Megjithëse është kthyer disa herë për përpunim, Studimi një dekadë i vjetër është, sipas mendimit të profesionistëve, plot "vrima" për shkak se është punuar sipërfaqësisht, pa gjendjen fillestare (zero) dhe testime të hollësishme.

"Lejimi i punimeve të tilla përbën në të njëjtën kohë shkelje të rregulloreve për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjen e florës dhe faunës (në nivelin shtetëror dhe ndërkombëtar). Nëse Agjencia e Mjedisit do t'i respektonte rregulloret shtetërore, nuk do të lëshohej asnjë leje për ndërtimin e mini-hidrocentraleve derivuese", thotë **Vuk Ikoviq**, një biolog nga organizata KOD.

"Në një shtet të rregulluar, një studim i tillë do të ishte tërhequr me kohë dhe të gjithë pjesëmarrësit në hartimin dhe miratimin e tij do të ndiqeshin penalisht. Në fund të fundit, pse paguajmë inspektimin dhe gjyqësorin kur institucionet nuk janë përgjegjëse për veprime të tilla të paligjshme", pyet Ikoviq dhe vëren se Studimi duhet të përmbajë gjendjen zero (fillestare) që nuk është bërë dhe se duhet të përmbajë studime serioze, e jo hamendësime.

Njëjtë mendon edhe biologu **Darko Saveliq**.

"Mendoj se mini-hidrocentralet në Kraljskih Bara nuk duhet të ndërtohen në bazë të dokumenteve ekzistuese. Sepse dokumenti kryesor që i ka dhënë dritën e gjelbër ndërtimit, pra Studimi mbi vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor nuk është hartuar në përputhje me ligjin. Për më keq, dy herë është kthyer në përpunim dhe sërish është i dobët", vlerëson Saveliq.

"Detyra e vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor është që të bëjë gjendjen zero (fillestare) të florës, faunës, botës së kërpudhave, tokës, klimës, ujit, ajrit etj. Dhe të vlerësojë ndikimin e investimit në gjithçka që është deklaruar në gjendjen zero. Në këtë studim, biodiversiteti i parkut natyror të ardhshëm është trajtuar në dy faqe jo të plota, pa asnjë fjalë për amfibët, gjitarët, zvarranikët dhe zogjtë, ndërsa flora gjithashtu zë një prej dy faqeve", shton ai.

Speciet e mbrojtura të harruara

Gjatë vizitës në terren, krejt në skaj të ujëmbledhësit kemi filmuar me kamerë salamandrën, një specie të mbrojtur me ligj. Kjo nuk do të përbënte çudi sikur kjo specie të mos përmendej në Studim, gjë që ka ngritur çështjen për speciet e tjera të mbrojtura që mund të preken nga projekti i filluar i ndërtimit të mini-hidrocentralit. Ky është një lëshim serioz në hartimin e dokumenteve, pohojnë ekspertët.

Foto: Vuk Vujisiq

"Mini-hidrocentralet shkaktojnë zhdukjen ose reduktimin e salamandrave. Projektet e tilla ndikojnë para së gjithash negativisht te kafshët që janë të lidhura ngushtësisht me ujin, dhe të cilat kryejnë të gjitha ose shumicën e aktiviteteve të tyre jetësore në ujë. Ky është pikërisht rasti me salamdandrat", shpjegon Ikoviq.

Sipas tij, foletë e vezëve të amfibëve po zhduken në tërë Malin e Zi për shkak të presioneve të shumta.

"Bora po shkrihet më shpejt, reshjet janë të papritura dhe të pabarabarta, trupat ujorë po thahen më shpesh, kemi gjithnjë e më shumë tharje për shkak të urbanizimit. Kjo është arsyeja pse këto specie në Malin e Zi kanë rënë dukshëm në 50 vitet e fundit. Mini-hidrocentralet ndikojnë më tej në rënien e tyre dhe rrisin shkallën e tyre të zhdukjes. Ndërsa mirëqenia e një komuniteti njerëzor varet drejtpërdrejt nga një ekosistem dhe speciet e tij, humbja e botës së kafshëve do të ndikojë edhe në situatën ekonomike të qytetarëve", vazhdon Ikoviq.

Ai shton se salamandrat nuk mund të mbijetojnë në minimumin e përcaktuar ekologjik prej dhjetë për qind të rrjedhës së ujit dhe se përgjegjësia i përket Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit Jetësor dhe përpunuesit të studimit.

"Prej 845 specieve të mbrojtura në vend, përpunuesi i studimit gjen vetëm një, pra shushunjën. Gjendja zero (fillestare) nuk është kryer dhe ne nuk mund të dimë se si ky projekt do të ndikojë në speciet e tjera të mbrojtura", paralajmëron Saveliq.



INSTITUT "SIGURNOST" – PODGORICA strana 93 od 133

7.5.1.2.Uticaj na endemične i zaštićne vrste u zoni direktnog uticaja planiranog zahvata izgradnje hidroelektrana u slivu rijeke Crnje

Na području koje će biti izloženo direktnom uticaju nema endemičnih vrsta koje su stenoenedmične za dato područje (odnosno, da žive samo u rijeci Crnji) i koje su opisane sa ovog mikrolakaliteta.Međutim na području zahvata mogu se naći sledeće endemične vrste:

Vrste Partnunia naprintua Gerecke i *Partnunia puritana* Gerecke – locus typicus za obe vrste je Trešnjevik i vrsta *Partnunia naprintua* se može naći u rijeci Crnji.Obje vrste prefereiraju reohelokrene izvore bogate sa pijeskom i mahovinom (vidi Pešić i sar. 2010) tako da planirani zahvat neće značajnije uticati na njihove populacije.

Vrata Dina minuoculata, jedna od najkrupnijih Evropskih pijavica, endemična vrsta opisana od strane Prof. Grosser i Prof. Pešić, u svoj areal uključuje i područje Komova. Ova vrsta neće biti izložena negativnom uticaju planiranog zahvata jer je ekologijom vezana za ekoton.

Od vrsta koje su zaštićene zakonom (Uredba o stavljanju određenih biljnih i životinjskih vrsta pod zaštitu rješenjem Republički zavod za zaštitu prirode, Službeni glasnik RCG br 76/06a) a koje mogu biti izložene eventualnom uticaju treba posebno spomenuti vrstu *Dina lineata* (endemična podvrsta *Dina lineata montana* je opisana sa područja Komova).*Dina lineta* se može naći u rijeci Crnji u zoni izloženom direktnom uticaju.Ova vrsta po svoj prilici neće pretpteti značajniji uticaj koji bi doveo do značajnog ugrožavanja njene populacije jer je ekologijom vezana za ekoton, a može preživeti i u lentičkom planinskom staništu.

Od ostalih vrsta koje se eventualno mogu naći u zoni izložena direktnom uticaju je vrsta *Atractides longisetus* opisana od strane Pešić (2002).Ova vrsta je vezana za gornje djelove potoka (bliže izvorišnom dijelu) tako da se može očekivati da neće pretrpjeti značajan uticaj.

7.5.2 Gubitak i oštećenje geoloških, paleontoloških i geomorfoloških osobina

U toku izvođenja i eksploatacije projekta neće doći do gubitka i oštećenja geoloških, paleontoloških i geomorfoloških osobina.Lokacija objekta ne pokriva nalazišta minerala, paleontoloških i mineroloških pojava koje su ili bi trebalo biti zaštićene.

Podgorica, januar, 2011.god.

Foto: Vuk Vujisiq

Që Studimi është plot me lëshime na konfirmuan edhe dy adresa të tjera mjaft të rëndësishme dhe profesionale, të cilat në fund nuk dëshironin të deklaroheshin publikisht për shkak të raportit me përpunuesin e Studimit, por edhe presioneve të mundshme në punë.

Dr Peshiq thotë se mosrespektimi i masave nga Studimi sugjeron veprime korruptive

Një nga përpunuesit e Studimit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Dr. Vladimir Peshiq theksoi në një intervistë me PCNEN se ligji ekzistues i atëhershëm nuk parashikonte një studim të "gjendjes zero" dhe se Studimi më pas u bë nga literatura ekzistuese Për punën si biolog në hartimin e Studimit mori kompensim prej disa qindra eurosh.

"Studimi është bërë në vitin 2010. Pse është e rëndësishme kur është bërë studimi?

"Në atë periudhë kohore, ligji nuk parashikonte të bëhej paraprakisht studimi i të ashtuquajtures "gjendjes zero" të biodiversitetit. Detyrimi për të bërë studimin e gjendjes zero të biodiversitetit para se të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis është praktikë e re. Në atë kohë, unë u punësova nga një kompani që po vlerësonte ndikimin e ndërtimit të hidrocentraleve të vegjël në mjedis për të bërë një rishikim të florës dhe faunës për çmim 250 ose 300 eurosh, bazuar në atë që dihet nga literatura shkencore me theks të veçantë në speciet endemike dhe relikte", u shpreh Dr. Peshiq.

Peshiq beson se është e nevojshme të përgatitet një studim i ri që autoritetet kompetente janë përgjegjëse për mosrespektimin e masave nga ky ekzistues, i cili duhet të sigurojë pajtueshmëri me masat dhe rekomandimet për të shmangur dëmtimin e mjedisit.

"Besoj se ka nevojë për të bërë një studim të ri, para së gjithash sepse atëherë studimi nuk është bërë, dmth. një studim "i gjendjes zero" të biodiversitetit. Ekziston mundësi e madhe që kërkimet, të cilat gjithmonë duhet t'i paraprijnë një ndërhyrjeje të tillë, të çojnë në të dhëna për praninë e specieve të caktuara të mbrojtura dhe madje endemike, mbrojtja e të cilave do të kërkonte domosdoshmërisht propozimin e masave konservuese për mbrojtjen e tyre, që në fund të fundit,paraqet një nga qëllimet e vlerësimit të ndikimit," tha Peshiq.

Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit dhe ish MORT përsërisin se gjithçka ishte bërë në përputhje me ligjin dhe mundësitë, ndërsa qeveria e re shqyrton të gjitha parregullsitë dhe dokumentet në lidhje me rastet e hidrocentraleve të vogla në mënyrë që të merret një vendim mbi përfundimin e mundshëm të koncesionit.

Një gjë është e sigurt - vendasit thonë se nuk do të dorëzohen dhe se ata do të ruajnë lumenjtë e tyre pa marrë parasysh se kush do jetë në pushtet.

GRAĐANSKA
ALIJANSA
Civic Alliance - Aleanca Qytetare
UNITED STATES EMBASSY
PODGORICA